



# Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XII i botimit, nr. 124, shkurt 2014  
Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355683191817, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Lazër Kodra, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

## BEST 10 NORTH 6

### 10 PERSONAZHET SHKODRANË TË VITIT 2013

#### Dashuria shqiptaro-austriake në "Çadrën e Kuqe", të Fatos Baxhakut

Ditën e Marte, date 18 Shkurt 2014 ne mjedisin e Bibliotekës "Luigj Gurakuqi" te Universitetit Shkoder "Austria" u bë promovimi i Librit me titull " Çadra e Kuqe " e autorit Fatos Baxhaku, i cili realizoi me shumë profesionalizëm idenë e ish Ambasadorit te Republikës se Austrië ne Shqipëri e njeherit mik i Shqipërisë e shqiptareve, zotit Florian Raunig.

Shtetit shqiptar gjatë gjithë historisë se tij asnjëherë nuk i ka munguar mbështetja nga shteti Austriak dhe për këtë arsye tani kemi mirënjohës.

#### THETHI - GJITHNJË DHURON GJËRA TË REJA

MALET NJË GUASKË E HAPUR; THETHI NJË PERLË ALPINE RRËZË QIELLIT BLU. Ç'DALLGË I HODHI KËTU? XHEVAHIR SPAHIU

Thethi në çdo kohë të krijon përshtypje të veçanta, jo vetëm tek ata që e vizitojnë për herë të parë, por edhe tek ata që janë lindur dhe rritur në këtë vend. Unë jam lindur, rritur, jetuar dhe punuar 50 vjet në këtë vend, pa çka se edhe pas largimit çdo vit disa javë apo muaj më kthehem përsëri këtu.

Agjensia e Spektakleve "Buna 1", me President Arben Mazi, organizoi për herë të parë në qytetin e Shkodrës një mbrëmje në Teatrin "Migjeni", kushtuar 10 personazheve të vitit 2013, titulluar "BEST 10 NORTH", duke nderuar emrat e personaliteteve më të spikatur për kontributin e tyre në vite në sferat e ndryshme të jetës si: Shkrimtari më i mirë, Piktori më i mirë, Regjisori më i mirë, Aktori më i mirë i humorit, Aktori më i mirë i dramës, Këngëtari më i mirë, Sportisti më i spikatur, Biznesmeni më i suksesshëm, Politikani i vitit, Çmimi i mirënjohjes dhe Çmimi i karrierës.

#### EKSPOZITA "SHAN PICI-1938"

Një ftesë përcjellë mique të artit nga ana e organizatorëve, Shoqata "Atdhetare Dukagjini" në bashkëpunim me Fototeken "Marubi", bëri që mjediset e Galerisë së Arteve të Shkodrës, me datën 15 shkurt 2014, të mbushen me pjesëmarrje të gjërë vizitorësh për të ndjekur foto-ekspozitën "Shan Pici-1938". Mes pasionantëve të fotografisë, drejtuesve vendorë e më gjërë, si dhe një përfaqësie të gjërë të familjes së madhe "Pici", spikatin antarët e shoqatës "Atdhetare Dukagjini", krenaria e të cilëve qëndron në faktin, se me aparatën e tij fotografik, autori i kësaj ekspozite ka pasur në fokus historinë, traditën dhe mrekullitë turistike të zonës së Dukagjinit, dhe në përgjithësi të alpeve veriore. Në ekspozitën në fjalë, por edhe në albumin fotografik të përgatitur enkas për këtë qëlim, rreth 90-të përrëqind e tyre janë me pamje nga Dukagjini, pastaj nga Tropoja, Puka, por edhe nga Shkodra. Kanë qënë pikërisht këto foto me subjekt natyrën e Alpeve Shqiptare në vitet 30-të të shekullit të kaluar, me të cilat tregoi vlerat profesionale dhe artistike, duke e bërë Picin shumë të njohur në opinion nacional dhe atë ndërnacional.



#### FREDERIK RRESHPIJA NË 8 VJETORIN E VDEKJES SË TIJ

Frederik Rreshpja, vdiq 17 shkurt 2006. Pra, u mbushen 8 vjet që nga momenti që ndërroi jete poeti i madh shkodran, Frederik Rreshpja. Nuk u tha asgjë në media, pavarësisht se, ishte poeti më i talentuar që ka nxjerre Shqipëria, poet që përfaqëson denjësisht vendin tone dhe qytetin tone, ndërsa në nivelet e larta të botërore.

#### Dekonstruksioni postmodern: roli i anakronive të rrëfimit në roman

Arjeta FERLUSHKAJ

Rrëfimi jolinear apo fragmentar nuk është tipar që u shfaq në artin postmoderne sepse ka qenë i pranishëm që tek letërsia moderne. Por, mënyra se si përdoret ky "shkatërrim" i thurjes së modelit narrativ është i ndryshëm nga modernia: për hir të ironisë/parodisë (rasti i metafiksionit historiografik) apo parimeve formale postmoderne si: double coding-u, pastich-i, ikonoklazmi etj. Kompozicioni këtu merr një rol funksional sa i përket lojës me kohën sepse duke qenë i thyer dhe me paraqitje kryesisht eksperimentale ndikon në mënyrën e perceptimit të realitetit të rrëfyer në roman.

**SIGMA** VIENNA INSURANCE GROUP

Mundësoi Botimin: **NDUE FTONI**

# EKSPOZITA "SHAN PICI-1938"

Një ftesë përcjellë miqve të artit nga ana e organizatorëve, Shoqata "Atdhetare Dukagjini" në bashkëpunim me Fototeken "Marubi", bëri që mjediset e Galerisë së Arteve të Shkodrës, me datën 15 shkurt 2014, të mbushen me pjesëmarrje të gjërë vizitorësh për të ndjekur foto-ekspozitën "Shan Pici-1938". Mes pasionantëve të fotografisë, drejtuesve vendorë e më gjërë, si dhe një përfaqësie të gjërë të familjes së madhe "Pici", spikatin antarët e shoqatës "Atdhetare Dukagjini", krenaria e të cilëve qëndron në faktin, se me aparatën e tij fotografik, autori i kësaj ekspozite ka pasur në fokus historinë, traditën dhe mrekullitë turistike të zonës së Dukagjinit, dhe në përgjithësi të alpeve veriore. Në ekspozitën në fjalë, por edhe në albumin fotografik të përgatitur enkas për këtë qëlim, rreth 90-të përqind e tyre janë me pamje nga Dukagjini, pastaj nga Tropoja, Puka, por edhe nga Shkodra. Kanë qënë pikërisht këto foto me subjekt natyrën e Alpeve Shqiptare në vitet 30-të të shekullit të kaluar, me të cilat tregoi vlerat profesionale dhe artistike, duke e bërë Picin shumë të njohur në opinionin nacional dhe atë ndërnacional.

"Ne bijtë dhe pasardhësit e atyre banorëve që paraqiten aty, duhet, dhe i jemi mirënjohës të nderuarit Shan Pici dhe gjithë atyre që e nxiten dhe e mbështeten, ndër të cilët, në mos kryesori, ishte biri i Dukagjinit, poeti, themeluesi i tregimit modern shqiptar, romancieri, përkthyesi dhe publicisti, Ernest Koliqi, që pasqyrohet edhe në faqet e albumit", thotë sekretari i shoqatës "Atdhetare Dukagjini", Luigj Shyti. Me këtë rast, Shyti, kërkon, që: "... në emer të shoqatës që ai përfaqëson, të shprehë gjithë respektin dhe mirënjohjen e të gjithë dukagjinave, për fotografën e nderuar Shan Pici, por edhe për Fototeken "Marubi", stafin e saj dhe veçanërisht të drejtorit të saj, Luçjan Bedeni, për punën që po bëjnë në ruajtjen dhe publikimin e vlerave të tilla që i bëjnë nder gjithë nacionalitetit tonë".

Duke vëzhguar nga afër fotot e pasqyruara në këtë ekspozitë, dallon qartë që në stendat e saj, mjeshtri i fotos Shan Pici ka ditur të shprehë dashuri dhe respekt, art, kulturë dhe histori në ato male dhe ato malësorë. Aty pasqyrohet çiltërsia e atyre banorëve, e përzier me skamjen ekonomike e arsimore, të cilat nuk ja veniten asnjëherë, krenarinë, mikpritjen, besen dhe as vullnetin për të jetuar dhe për t'u zhvilluar.

## Flet personazi i gjallë i Picit

Një nga personazhet më interesante të ceremonisë promovuese të kësaj ekspozite, organizuar në Galerinë e Arteve Shkodër, ishte padyshim, Ndue Dede Mhilli, nga Shoshi i Dukagjinit. Sot, në moshën 82 vjeçare, ai padyshim ka të drejtë më tepër se kushdo tjetër të ndjejë emocione, por edhe

kënaqësi, se njëra prej fotove të të kësaj ekspozite, është portreti i tij, i cili është fiksuar në moshën 6 vjeçare nga fotografi i pasionuar, Shan Pici, foto që në fakt është e ekspozuar edhe në faqen numër 71 të albumit me të njëjtin emër. Teksa e aparatit i ATSH-së e fikson, pikërisht përpara kësaj foto, dukagjinasi fisnik, Ndue Mhilli, kujton me nostalgji 76 vite më parë, kur i madhi Shan Pici, tekta po vizitonte mrekullitë e natyrës së kësaj ane, e pati ndalur dhe kërkuar ta fiksonte atë në aparatën e tij fotografik. "E mbaj mend si sot, kur m'u afrua, ku

e ka punuar në sektorin e ushtrisë, vijon të jetë sërë prezente dhe aktive nga trashëgimtarët e tij. Nikolini, si djali i madh i Shan Picit, ka qënë i pari që ia ka marrë zanatin babes së tij. Pas tij, ka ardhur edhe vëllai tjetër, Pjerini, ndërkohë, që tradita tashmë vijon në një brez tjetër, me djalin e Nikolinit, Marketin Pici, një tjetër pinjoll i Picëve në këtë gjini, studioja e të cilit është ndër më të spikaturat në Tiranë. Duke vijuar të flasë për të atin, Nikolini, thotë se Shani ishte me të vertetë shumë i zoti në këtë zanat, duke bërë mrekullira gjatë karrierës së tij të

të familjes, janë trashëgimtarët më të afërt, jo vetëm të familjes, por edhe të profesionit të Shan Picit.

## Dekorimet

Natyrshëm, krahas vlerësimeve dhe konsideratave maksimale në adresë të Shan Picit, për atë që me artin e tij fotografik ka përjetësuar një pjesë të mirë të historisë së atyre viteve për Dukagjinin dhe dukagjinasin, kryetari i shoqatës "Atdhetare Dukagjini", Ndue Sanaj, pati kënaqësinë t'i dorëzonte dy djemve Shan Picit, Nikolinit dhe Pjerinit, titullin "Mirënjohje e Shoqatës Atdhetare-Dukagjini" (pas

1938", i cili ju dorëzuar Drejtorit të Fototekës "Marubi", Drejtorit të saj, Luçjan Bedeni. Në prononcimin e tij për ATSH-në, kreu i Shoqatës "Atdhetare Dukagjini", Sanaj, tha se shoqata që ai drejton prej disa vitesh, është mjaft aktive në organizimin e aktiviteteve kulturore-artistike, në objektivin e së cilës është promovimi i vlerave historike e turistike të zonës së Dukagjinit, që në këtë rajon janë me të vertetë tipike për vendin tonë.

## Vlerësimet

Vlerësimet dhe konsideratat për ekspozitën fotografike, "Shan Pici 1938", të organizuar në Galerinë e Arteve Shkodër, ishin të shumta. Për drejtorin e kësaj galerie, piktorin e njohur, Artan Draçini, vepra fotografike e Shan Picit është pak, pothuaj aspak e njohur për publikun tonë, ndonëse kemi të bëjmë me një pionier të fotografisë së pejsazhit. "Në vitet 1930, Pici e mori artin e fotografisë me vete nëpër male. Ai është fotografi i parë shqiptar që hapi sytë, dhe objektivin e aparatit të tij fotografik për bukuritë e mjedisit natyror", thotë Elsie në parathënie të katalogut të botuar me këtë rast", bën të ditur Draçini, duke risjellë në vëmendje konsideratat e tija personale për këtë autor. Ndërkohë, duke iu referuar ekspozitës në fjalë, Draçini, thotë se "... spektatori ftohet të admirojë pejsazhin artistik, kompozimin, dritën, shtrirjen e planeve, madhësinë e siluetave të maleve dhe ekspresivitetin e personazheve të trajtuar".

Arkivin fotografik të Shan Picit, drejtori i Fototekës Kombëtare "Marubi", Luçjan Bedeni, e konsideron një pasuri të madhe për institucionin që ai përfaqëson. Sipas tij, menjëherë pas dinastisë Marubi, emri i Shan Picit është një nga më të spikaturit në fushën e fotografisë, jo vetëm në Shkodër, por edhe më gjërë, arkivi e të cilit e ka pasuruar në mënyrë të ndjeshme Fototekën "Marubi". Bedeni shprehu kënaqësinë që në bashkëpunim me shoqatën "Atdhetare Dukagjini", arriten të promovojnë pasurinë e fotove të Picit për ardashësit shkodranë, të cilët do të kenë rastin ta shijojnë ekspozitën deri në fund të muajit në mjediset e Galerisë së Arteve Shkodër. Falenderimi për drejtuesit e shoqatës Dukagjini nga ana e Bedenit, shkon edhe për kontributin e çmuar që dhanë ato në përcaktimin dhe saktësinë e deciturave të fotove të shkrepuara nga autori Shan Pici.

Për punën dhe vepren e fotografit të njohur Shan Pici, foli me shumë respekt, edhe kreu i Qarkut Shkodër, Maxhid Cungu, duke bërë të ditur se Shkodra dhe mbarë komuniteti i rajonit verior në përgjithësi i është mirënjohës fotografit Shan Pici, për gjithçka bëri në evidentimin dhe pasqyrimin e vlerave historike dhe turistike të kësaj zone.

Përgatiti Gac Marku



Familja Pici

duke më përshëndetur me dashamirësi, më tha që të vendosa përballë aparatit të tij", thotë Ndoja,

pasur artistike, ku me pasionion e vetë, me aparat fotografik në dorë shkeli në të gjithë Malësinë e Veri-

vedekjes) për fotografën, Shan Pici, me këtë motivacion, "Për hulumtimin dhe pasqyrimin e vlerave



Ndue Dede Mhilli, sot 82 vjeçar, përballë fotos së vitit 1938, në moshën 6-vjeçare, shkrepuar nga mjeshtri Pici

duke risjellë në vëmendje portretin e tij që mishëronte vetëm mirësi e dashuri për ato anë dhe banorët e saj. Fati e sjellë që pas 76 vitesh, ai të jetë personash në ekspozitë si dhe në album, që për të është një tjetër befasi dhe kënaqësi tejet e madhe, aq më tepër se vetë djali i Shann Picit, Nikolini i dhuron një kopje të albumit, ku është brenda edhe fotoja e tij.

## Tradita e familjes Pici

Nikolin Pici, një fotograf i njohur, që për shumë vite profesionin e tij

ut duke na lënë këto foto origjinale të historisë së atyre viteve. "Por, jo vetëm malësitë, pasi Shani deshi edhe qytetet, duke filluar me atë të Shkodrës, ku një pjesë e "Picëve" jetojnë edhe sot, duke pasur në fokus, krahas pejsazheve, sidomos portretin, që nga njerëzit më të thjeshtë, të veshur e të paveshur, fukara, e te tjere, deri tek vipat më të spikaturit të qytetit, për të vijuar me foto interesante edhe në qytetet e tjera të Shqipërisë.", thotë Nikolini, jo pa krenari që ai dhe pjesëtarët e tjerë

kulturore, artistike, historike e turistike të Dukagjinit në vitin 1938, të pasqyruara në albumin "Shan Pici 1938". Gjithashtu, titulli "Mirënjohje e Shoqatës Atdhetare-Dukagjini", ju dha dhe Fototekës "Marubi", me motivacion: "Për punën e bere në ruajtjen dhe publikimin e vlerave të jashtëzakonshme që mbart e veçanërisht në botimin e albumit "Shan Pici-1938", në botimin e kalendarit për vitin 2014, në hapjen e fotoekspozitës, që pasqyrojnë jetën në Dukagjin, në vitin

# Dashuria shqiptaro-austriake në “Çadrën e Kuqe”, të Fatos Baxhakut

Ditën e Marte, date 18 Shkurt 2014 ne mjedisin e Bibliotekës “Luigj Gurakuqi” te Universitetit Shkoder “Austria” u bë promovimi i Librit me titull “Çadra e Kuqe” e autorit Fatos Baxhaku, i cili realizoi me shumë profesionalizëm idenë e ish Ambasadorit te Republikës se Austrisë ne Shqipëri e njeherit mik i Shqipërisë e shqiptareve, zotit Florian Raunig.

Shtetit shqiptar gjatë gjithë historisë se tij asnjehere nuk i ka munguar mbeshtetja nga shteti Austriak dhe për këtë duhet te jemi mirënjohës.

Ky aktivitet u realizua duke paraqitur dhe nje aspekt te errët, e te panjohur te marrëdhënieve austriako-shqiptare, me fatet emigranteve austriake, te cilët jetuan në Shqipëri, rreth shekujve XIX-XXI, ku shumë familje austriake përjetuan vuajtje të rënda te sistemit diktatorial, duke iu nënshtruar përndjekjes dhe diskriminimit. Ato larmi historish e ngjarjesh apo dëshmish, kontaktesh mes austriakeve e shqiptareve janë bërë objekti i veprimtarisë e që u pasqyruan nëpërmjet librit te z. Baxhaku.

Ne aktivitet fjalën e mbajti së pari z. Gjergj Leqejza, i cili përcolli admirimin dhe vleresimin e tij per librin, dhe punen e palodhur e profesionale të z. Baxhaku. Libri u konsiderua i një rëndësie të veçantë për faktin se shërben si themel për vazhdimsinë apo përmblidhjen e mëtejshme të historisë së përbashket austriake-shqiptare për zbulimin e zbardhjen e shumë ngjarjeve e fakteve te fatit te këtyre njerëzve e familjeve.

Z. Baxhaku tregon mbi librin e tij, një libër që i përket një vlere historike deri ne nje kufi te caktuar pasi, libri faktikisht e ka bazën e fortë ne rrënjët e historive te pasuesve te familjeve austro-shqiptare, që ende jetojnë ne Shqipëri.

Autori percjell dhe vështirësinë apo pengesat që takoi gjate rruges ne grumbullimin e të dhënave dhe fakteve histo-



rive, ku në shumë raste behej fjalë për pasardhes te brezit te tretë apo te katërt e kujtimet vinin si të turbullta e të vagullta, por ishin dhe ato ngjarje që kishin në

përmbajtjen e tyre bukurinë. Autori i veprës nje falenderim të vecant ia dedikon dhe fotografes Znj. Jutta Benzenberg, ku sipas tij libri nuk do ishte asgjë tjetër

veçse nje tekst i thatë pa ato foto e ilustrim të gjallë të familjeve.

Z. Petrit Ymeri në fjalimin e tij shprehet për punën madhore të z. Baxhaku duke paraqitur para auditorit vlerat e jashtëzakonshme të librit. Ajo çka ia shton vlerat e shkëlqimin librit është pikërisht fakti që i përkasin një realiteti, histori reale fate-sh njerëzore, me copëza lumturie e dashurie, dritherimash e frike, ditë gëzimi, shkëlqimi, ngritjeje, renie apo errësimi, me gjith ato elemente të jetës reale.

Ai theksoi se janë edhe projekte të tjera, të cilat presin që në të ardhmen ta pasurojnë edhe më shumë frytshmërim e raporte dhe të mira dhe strehën që ju dha talenteve shqiptare në të gjitha fushata nga shteti Austriak.

Mjaftë emocionues për auditorin ishte dhe dëshmia e znj. Loreta Prela si përfaqësuese e këtyre familjeve. Fakte dhe fatet të panjohura, por që përcjellin dhimbjen e asaj kohë, e cila edhe fliste në emër të dashurisë, dashurisë I vuri shkëlqimin shkëlqimshëm. Por si gjithmonë edhe pse me dhimbje të mëdha ajo ngallnjeu.

Aktivitetin e pasuruan me praninë tyre edhe auteritete vendore, ku përmendim Prefektin e Qarkut të Shkodrës, Paulin Radovani i cili në fjalën e tij pas falenderimit për punën e bërë, dëshmoi për praninë në vendin tonë edhe shumë shtetasve të tjerë evropian, të cilët kishin të njëjtin fat të presekutimit të tejskajshëm.

Ja vlen të përmendim ndërhyrtjet që bënë disa nga të pranishmit, si Gjergj Dinella e Manfred Tagini, profesor i shkolles austriake “Peter Mahringer”, të cilët sollën falenderimet dhe vlersimet e tyre për punën e bërë nga z. Fatos Baxhaku. Pikërisht ky realitet, këto fate të përbashkëta të shqiptarëve e austriakëve dhe marrëdhëniet mes tyre ne shekuj, janë bërë dhe objekt konkret nëpërmjet dokumentimit te tyre nën një vepër të realizuar, sic është dhe vepra e “Çadra e Kuqe” e z. Fatos Baxhaku.

Në përfundim ja vlen të përmendim monitorimin e përkryer që i dhuroi këtij aktivitetit z. Gjergj Leqejza.

Daniela Pjetri

## DITA E TË DASHURUMEVE



Nga Ndoc Selimi

**Pak Histori.**

Shën Valentini, asht mbrojtësi i të dashuruarve dhe padron i qytetit Terni në Umbria-Itali. Legjendat dhe traditat

popullore flasin për mrekullitë dashurore që ka ba shenjt i gjate gjithë jetës së tij. Asht lind në Terni, rreth vitit 175 mbas Krishtit dhe me 197 behet i pari ipeshkëv i qytetit. Thuhet se, Celebroi martesën e një të reje kristiane të quajtur Serapia me një legjionar pagan të quajtur Sabino. Për këtë dënohet me heqje koke nga Imperatori i Romes.

Në vendet anglosaksione asht e njof-tun legjenda, me të cilën ipeshkvi Valentino pa se dy të riye të dashuruar po ziheshin. Ai këputi një lule trëndafil dhe ua dhe të rinjve. Të rinjtë ndërruan mendim menjëherë e filluan të putheshin. Kjo ngjarje u hap shpejt dhe të gjithë të rinjtë më vonë të dashuruar vraponin te ipeshkvi që i bekonte me një trëndafil secilit çift.

Varianti i trete i festimit të kësaj dite asht se ipeshkvi Valentin kunorzonte të

riye për të mos shkuar ushtarë, pasi të martuarit ishin të përjashtuar nga shërbimi ushtarak sipas ligjit. Në kohën, kur Klaudio ishte Perandor në Rome dha urdhër që të ndërpriteshin të gjitha celebrimet martesore, pasi po pakësoheshin ushtarët. Ipeshkvi Valentini filloi ti pagëzoje në mshehtësi duke thyer urdhrin e Perandorit dhe për këtë dënohet me vdekje.

Ka edhe një variant tjetër, sikur në këto dite të shkurtit, romaket festonin rilindjen e Pranverës dhe të gjitha të rejat që donin të martoheshin, shënonin emrin e tyre në një vazo me lule dhe e dërgonin në një vend të caktuar, ku vinin djemtë të nesërmen e merrnin nga një vazo pa e dite se e kujt ishte. Kështu lindte dashuria në mes të rinjve.

Nga të gjitha këto fakt asht se, Shën Valentinit iu pre koka dhe data 14 shkurt hyni në histori si dita e të dashurumeve.

Mbi varrin e tij në Terni është ndërtuar një kishë madhështore ne emrin e shenjtit Valentin.

Të rinjtë dhe të rejat e dashuruar në gjithë boten kane lutjen e tyre drejtuar Zotit:

*“Ne zëmër time, Zot, asht ndeze dashuria për një krijese që ti e nje dhe e do. Ban që unë të mos humb ketë pasuri që ti me ke futur në zemër. Mësom që dashuria asht një dhurate dhe nuk mund të perzihet me asnjë egoizëm...Të lutem Zot për atë që më pret dhe më mendon, për ke më ke dhanë gjithë besimin e të ardhmes duke i dhanë njani - tjetrit ndihme dhe model. Ban Zot, që me ndihmën e Shën Valentinit na ndihmo e na përgatit për martesën dhe madhëstini e saj. Duke fillu qysh sot shpirtat tone të pushtojnë trupat tone dhe të mbretrojnë ne dashuri. Amin!”*

Të dashuruar! U uroj gëzime e lumturi ne jete!

# THETHI - GJITHNJË DHURON GJËRA TË REJA

MALET NJË GUASKË E HAPUR; THETHI NJË PERLË ALPINE RRËZË QIELLIT BLU.  
Ç'DALLGË I HODHI KËTU? XHEVAHIR SPAHIU

Thethi në çdo kohë të krijon përshtypje të veçanta, jo vetëm tek ata që e vizitojnë për herë të parë, por edhe tek ata që janë lindur dhe rritur në këtë vend. Unë jam lindur, rritur, jetuar dhe punuar 50 vjet në këtë vend, pa çka se edhe pas largimit çdo vit disa javë apo muaj i kaloj përsëri këtu. Ky fshat i vendosur rrëzë Alpeve Shqiptare tërheqë me të veçantat e tij, me bukuritë dhe të rejtat që mund ti zbulosh shumë shpesh, por mua dhe, jo vetëm mua, më tërheqë sepse është vendi ku jam lindur. Ky vend nuk harrohet kurrë.

## "Plaku" që kuvendon me ujin

Para disa vitesh, si dashamirës i fotove të peizazhit, bërë disa foto edhe nga Ura e Gerlës mbi Kanjonin e Grunasit.



Më pëlqente kjo pamje, kjo ngushticë, ai ujë që rridhte nëpër të, pra ai kanjon i bukur që ka vende që pak centimetra e kalon metrin për gjerësi. Ato foto i bëra në kohë të ndryshme të ditës. Pas pak kohësh po i shikoja qetësisht në shtëpi. Për çudinë time, në disa prej atyre që kisha bërë rreth mesditës, kur dielli ka ndriçimin më të plotë në këtë vend, më përfytyrohet një pamje shumë interesante. Tamam në buzë të ujit përvijohet pamja e një kokë plaku, me ballin e gjerë, me sytë sikur shikon ujin që rrjedhë, hunda e tij sikur është zgatur pak nga mosha, e pastaj mjekra me leshrat e saj që takonin ujin. Shumë e bukur dhe interesante. Ajo foto më ka nxitur që të shkoj edhe disa herë të tjerë, bashkë me foton në dorë, për të bërë krahasimet dhe identifikimin e shikimin me sy të lirë në natyrë. Që herën e parë që u ktheva për ta riparë atë pamje, pasi prita rreth 1 orë e gjysmë që

binte sa më mirë ndriçimi e pashë shumë qartë, një masiv shkëmbi që uji dhe koha kishin skalitur atë portret të bukur, aty buzë rrjedhës së ujit të lumit. "Leshrat e mjekrës" takonin ujin, e ai sikur i përkëdhelte apo i krihte pa pushim më ëmbëlsi. Ndërsa i vështron, i përhumbur në monotoninë e tyre, të duket se gurgullima e ujit e oshtima e grykës së shkëmbit kuvendojnë, një kuvendim që vjen thellë nga his-



toria dhe do të shkojë thellë në histori. Kjo pamje magjepse shikohet vetëm në verë, kur niveli i ujit bie dhe ndriçimi është më i mirë.

## Dëllinja e veçantë...

Para disa kohe, ndërsa kthehesha nga një vizitë te Ujëvara e Grunasit, në të djathtë të prroit që zbert nga kjo ujëvarë, buzë tij, rastësisht më shkojnë sytë tek një pemë me kurorë të bukur konike, e gjelbërt, e dendur me gjethe në formë luspe por që përfundonin me majë shpuese. Afrohem e shikoj dhe, me gjithë njohjen që jam përpjekur të bëj për bimësinë e këtij fshati, këtë lloj po e shikoja për herë të parë. Pasi bëra disa foto, marr edhe një degë dhe pasi u ktheva në Shkodër u konsultova në Katedrën e biologjisë pranë Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" dhe rezultoi se ishte një lloj i veçantë dëllinje që literatura shkencore nuk e kishte përshkruar se ishte e pranishme në Theth. Me përjashtim të një bime tjetër që gjendet rreth 10 metra me larg nuk është takuar në asnjë vend tjetër në Thethit.

Kjo lloj e radhë dëllinje që rritet në këtë vend, shton edhe një mundësi më shumë për të vizituar këtë vend, shton edhe një objekt interesant në këtë territor. Ajo mund të vihet në mbrojtje sepse tregon veçori në bimësinë e Thethit.

## "Zemra" në zemër të Radohinës.

Kur je në anën lindore ose juglindore të Thethit, ke përballë malin madhështor të bukur dhe të lartë të Radohinës. Është mali i tretë për nga lartësia në Shqipëri. Me qindra herë, për të mos thënë më mijëra e kam shikuar, dhe qindra foto ju kanë bërë këtij mali në çdo stinë, nga shumë e shumë dashamirës dhe studi-



ues. Ajo është pamja klasike që ka prezantuar Thethin, ndoshta më e hershmja, por edhe nga më të bukurat. Kam soditur me dëshirë pamjet që të ofronte ky mal në verë e dimër, kam parë stuhi bore dhe shiu mbi shpatullat e saj, kam parë dhe dëgjuar oriqet që zbrisnin nëpër shpatet e saj vullshëm, dhe me oshtimë shurdhuese, i kam soditur shumë gjerë shpatët e këtij mali, por një gjë të veçantë e identifikova vetëm në gushtin e vitit të kaluar.

Ishte diku rreth orës 10.00 dhe së bashku më mikun tim Luigj Vukzaj po rrinim nën hijen e një pemë afër shtëpisë, në Gjellaj. Përballë kishim Radohinën. Dita ishte e bukur. Po bënim foto për qefin tonë. Aty ishte edhe Xhilda, vajza e motrës time të vogël, që është studente, e cila vinte për herë të parë në Theth, ndërsa shikon fotot në aparat fotografik menjëherë thotë: "shikoni sa bukur duket kjo pjesa këtu, si zemër" dhe tregonte me gisht pamjen, pastaj ktheu kokën për të parë malin përballë. Na tërhoqi edhe ne të tjerëve. E shikuam me vëmendje, bëmë krahasime të fotos dhe pamjes natyrore, dhe, vërtetë dukej si të ishte gdhendur një "zemër" gjigande në "zemrën e Radohinës". Kjo "zemër" e gdhendur nga natyra gjatë qindra vjetësh, në faqen e Radohinës quhet "Lugu i Madh" por asnjë herë nuk e kishim shikuar si formën e një zemra, që vërtetë paka qenë e tillë. Aty ishte dhe ka qenë për qindra vjet. Ishte dhe është jo thjeshtë e bukur, por, e papërsëritshme.

## Hej, kujdes...

Thethi është fshat fundor deri në kufirin shtetëror me Malin e Zi për këtë pjesë të territorit. Natyrisht që është 75 km larg nga qyteti i Shkodrës, por nuk

duhet menduar se është i mbrojtur nga ndotja me materiale jo dashamirëse me mjedisin.

Turizmi ka të mirat e veta, nxitë zhvillimin, rritë mirëqenien, rritë nivelin kulturor, por edhe veprime jo dashamirëse

me mjedisin, si hedhja e mbeturinave, erozioni, e te tjera.

Çdo person, qoftë ky banorë i përhershëm apo i përkohshëm, turist vendas apo i huaj, duhet të ndjejë përgjegjësi ndaj këtij fenomeni, sepse ndotja ka veprim me afat të gjatë. E duam ajrin e pastër, e duam freskinë e ëmbël, e duam ujin e kristaltë, por a shkojnë këto më grumbujt e mbeturinave në vende publike apo të hedhur aty këtu, e aq më keq hedhja e tyre në përrrenj lumë apo buzë tyre sepse aty do të përfundojnë.

Ka disa vite që B3P është angazhuar fort në Theth edhe për mbrojtjen e mjedisit jo vetëm duke zhvilluar veprimtari edukative të frytshme, por edhe duke vepruar praktikisht me nxënësit dhe të gjithë edukatorët. Natyrisht nga një veprimtari e tillë nuk mund të mbahet pastër gjatë gjithë vitit sepse shkolla verorë ka kohë të kufizuar, por ndikimi saj është me rëndësi në ndërgjegjësimin e komunitetit dhe turistëve. Sidomos qendrën e fshatit nxënësit dhe mësuesit e shkollës verore e kishin në qendër të vëmendjes dhe kur mbyllej veprimtari territori përreth ishte mjaftë i pastër. Ishte metodë punë, por në vitin që kaloi duket se nuk u vlerësua edhe aq mire sepse të nesërmen që u mbyllë veprimtaria kishte plot grumbuj mbetjesh deri edhe buzë lumit në qendër të fshatit.

\*\*\*

Thethi gjithnjë të dhuron gjëra të reja, të bukura dhe të mira. Ai është vërtetë perlë dhe kështu duhet të qëndrojë.

Luigj SHYTI

# FREDERIK RESHPJA NË 8 VJETORIN E VDEKJES SË TIJ

Frederik Rreshpja, vdiq 17 shkurt 2006. Pra, u mbushen 8 vjet që nga momenti që ndërroi jete poeti i madh shkodran, Frederik Rreshpja. Nuk u tha asgjë në media, pavarësisht se, ishte poeti më i talentuar që ka nxjerre Shqipëria, poet që përfaqëson denjësisht vendin tone dhe qytetin tone, Shkodren, në nivelet e larta të poezisë botërore. Fatmirësisht sot, secili mund të shijojë dhe vlerësojë poezitë e tij. Duke qene i sigurt se poezia e Rreshpjes do jete gjithmonë në panteonin e poezisë shqipe dhe më gjere, desha të risjell në kujtesën tuaj, miq, disa vlerësime të bëra nga autore të huaj, si dhe një kolazh të vogël me poezi nga i madhi Rreshpja, që janë perla të artit të fjalës.

- Hans Joacim Lanksch; "... vepra e Frederik Rreshpes është poezi e dorës së parë e kalibrin evropian",
- Robert Elsie: "... që në rininë e tij Rreshpja ka qene një poet tronditës",
- Henri Izrael, botues amerikan: "... është një poezi tronditëse dhe me një mjeshtëri që ne amerikanëve na mungon",
- Ivanov, kritik rus: "... ne kemi Pushkinin, Jeseninin, dhe shqiptarët duhet të jenë krenarë që kanë një poet të tillë",
- Leo de Rua, kritik francez: "... u trondita nga ky njeri që përmban një gjenialitet ballkanik, që është vendi i lindjes së artit",

## PËRGJITHMONË

O ajr i mbrëmjes mbështillmë, erdhi ora të vdes përsëri. Kur të mbyllen sytë e mi, nuk do të ketë më det. Dhe varkat e lotëve kane për te ngecur ne stere. Shkoj dhe shirat po i le të kyçura Por do të kthehem përsëri në çdo stine qe te dua. Unë kam qene trishtimi i botes.

+ O ajr i mbrëmjes mbështillmë, erdhi ora të vdes përsëri.

## TESTAMENT

Që fëmijë e kam kuptuar se kisha lindur i mallkuar me art.

Gjërat i shihja ndryshe:

Nëpër shirat e vdekur peshqit fluturonin drejt Çerdheve, te yjet. Në vend të borës binin zogj

në çdo dru.

Era si ketër brente degët.

Qante mbi mua nëna, shemëria ime. Ave nëna ime!

Mos e pastë njeri këtë fat!

Kam dashuruar një Afërditë në Olimpin

e trëndafilave.

Pastaj erdhe ti tërë ikje.

Më vonë vije vetëm nëpër ëndrra, si perënditë ilire.

Kështu iku edhe rinia, filigrani i djalërisë,

i mallkuar me art.

Mos e pastë njeri këtë fat!

Tani që po vdes ëndërroj vetëm një kryq te koka

dhe të harrohem se nuk dua që edhe pas vdekjes

të më ndjekë mallkimi i artit.

Mos e pastë njeri këtë fat!

Po kur të vdes portreti im ka për t'u shfaqur nëpër

gjethe,

se unë kam pasur miqësi me çdo dru.

Në stinën kur bien gjethet

do të bien edhe sytë e mi.

Tani e tutje shirat do jenë lotët e mi.

Mos e pastë njeri këtë fat!

Vdekja e Lorës

Rri në muzg sikur të janë rrëzuar kohërat përsipër,

gati për përjetësi.

Nuk më flet. I ke premtuar vdekjes, e kuptoj.

Por ti në këtë botë erdhe për mua, jo për qiejt.

Kemi qenë përherë bashkë, që të rinj,

Dhe tani më le!

Mua më trishtojnë stinët. Ti e ke ditur,

dhe me botën më ndan një udhë me kilometra vetmi

Kemi thënë gjëra që s'kanë për t'u kuptuar kurrë.

Kemi ecur në tërë shekujt, para piramidave,

emrat tanë kanë qenë gdhendur

edhe kur nuk kishim shkëmbinj.

Por këto s'kanë për t'u kuptuar kurrë.

Si ungjijtë.

Të dy kemi qenë gjithmonë të bukur, por ti tani

Je akoma më e bukur, kështu me pak vdekje në sy.

## KTHEHU

Ngado që sillem, pikëllimi është aty te porta



dhe prapëson shpirtat.

Te dritarja një shi i huaj, i verbër, pa zhurme.

Mbase janë shirat qe kane rene dikur,

mbase janë kufomat e shirave:

Çdo gjë është e trishtuar sonte.

Dal netëve pa hëne i vetmuar

Mos te vdesësh ne krevat, thoshte babai,

te vdesësh ne lufte, biri im;

Sidoqoftë një here do ikësh nga kjo bote,

por duhet te ikësh si trim.

Tere trimat e fisit tone kane shkuar

nga shpata ose plumbi, ne atë bote.

Kjo është një vdekje qe ia vlen, biri im,

çdo vdekje tjetër është e kote.

Por unë linda ne një kohe pa shpata,

kohe komunistësh frikacake,

ndaj me keni pare netëve pa hëne te vetmuar neper

rruge,

duke kërkuar fatin qe me la im atë.

Përgatitur nga Jetmir Shpuza  
dhe Keti Bazhdari

## U NDA NGA JETA MARK MITËR PAPLEKAJ

Në ditet e para të këtij viti u nda nga jete një tjetër ikonë e trashigimise tone burrnore, një burre i nderuar i maleve të Dukagjinit, një tjetër kollos i folklorit ....

Në ditët e para të janarit u nda nga kjo jetë Mark Mitër Papplekaj Babai artisteve të mirnjohur Syk dhe Gofile Papplekaj

Ai ishte një burrë mendjeholle, i zgjuar në jëtë e në kuvende të burrave,

Ai ishte një artist i lindur që në odat malsore në skenat e festivaleve me lahuten e tij për 50 vjet me rralle përcodhi ndër brez eposin e Kreshnikëve, traditat dhe vlerat më të mira të trashigimisë tone muzikore..

Kushdo që e ka njohur, kushdo që ka punuar me të, ruan kujtimet më të bukura për humorin, tregimet dhe kujtesën e tij të jashtëzakonshme. Mbase, pak nga pak po largohen nga kjo bote burrat e dhomave, të

kuvendeve, burrat që përfaqsojnë krenarinë dhe fisnikrine e kullave me oxhak ... një i tille ishte edhe Mark Mitri.

Ky është një lajm i trishte për të gjithë ata që e kane njohur, ndërsa për familjen e tij, për miqtë e të afermit, është një tjetër boshllëk i madh në arkivën e memorjes, miresise, fisnikerise, kultures dhe kujteses më të bukur të Nikaj-Merturit dhe gjithë Shqiperise.

Gjate viteve të fundit kam pasur rastin ta takoj disa here këtë burrë fisnik, dhe ruaj kujtime të veçanta nga takimet me të, ndiej dhimbje dhe keqardhje që një tjetër thesar i çmuar i rashigimise kulturore dhe gojore, do ti mungoj artit dhe kulturës.

Ngushëllime gjithë malsise për atë që do të mungojë përjete, për Markun, që diti të printe e të nderonte si askush tjetër me fjalën dhe prezencen e

tij në skena kuvende, ne dasma e ne morte.

Ngushëllime për arkiven e gjalle të tradites homerike të këngës dhe gjames se burrave. Ai ishte një njohës i përkryer i evolimit të asj nder breza, por edhe një interpretues i veçantë.

Ngushëllime për lahutarin, qe veshitire te perseritet, bartesin dhe njohesin e rralle të tradites dhe jetës se fisme e të pastër të Nikaj-Merturit e të mbare Dukagjinit.

Në familjen e tij, brezat përcollen traditën, pas Sykut e Gofiles edhe mbesa e tij Synjona Papplekaj, por shkruan emrin e saj në eliten e artisteve te kesaj familje. Në ditet e fundit të dhjetori isha shumë afer tij, në Teatrin "Migjeni", dhe e kujtoj si tani se, me sa emocion e ndiqte interpretimin e vajzes dhe mbesës të tij ne skene ...

Ngushëllime për largimin fizik te tij nga kjo jete, ndersa vdekja

është një dukuri që nuk arrin dot deri tek emri dhe lavdia e Mark Mitrit, sepse në jetën e tij ai shkroj pavdeksine në art, në kulture, në fjale e ne trashegimi të vyer për familjen, krahinen dhe nacionalitetin tone.

Ai u percoll me nje ceremoni madheshtore dhe sic e kishte merak edhe me gjame burrash. Sot gjama e burrave u nda nga shpirti dhe burrat e gjames u ndane nga prijesis. Lum ajo skene që e pati kënetar, lum ajo dasëm që e pati kryekrushk, lum ata njerz qe ju ka ndodhur ta kenë bashkudhtare në jetë, E pata mik e sic thoshte ai vete, mik per qefti. Para shumë vjetesh e pata edhe mësuës, më mësoj lahuten, këngën dhe më nxori në skene. Nje vit më pare i mesoj edhe Dejvit, djalit tim, ti binte lahutes. Po e perjetoj fort dhimbshem largimin e tij nga kjo jete – kështu do të shprehej pak dit më vonë miku i tij, Ndoc Mulaj.

Më takoj mua, rasti që të shkruaj këto pak rreshta, për këtë burrë të nderuar, për këtë



vlërë te çmuar të artit dhe të kulturës. që u nda para kohe nga jeta, por jam i bindur se ëahtë shume pak nga emri i nderuar që ai i la trashigim familjes dhe të afermve të tij.

Pergatiti Lulash Brigja

# BEST 10 NORTH

## 10 PERSONAZHET SHKODRANË TË VITIT 2013

Agjensia e Spektakleve "Buna 1", me President Arben Mazi, organizoi për herë të parë në qytetin e Shkodrës një mbrëmje në Teatrin "Migjeni", kushtuar 10 personazheve të vitit 2013, titulluar "BEST 10 NORTH", duke nderuar emrat e personaliteteve më të spikatur për kontributin e tyre në vite në sferat e ndryshme të jetës si: Shkrimtari më i mirë, Piktori më i mirë, Regjisori më i mirë, Aktori më i mirë i humorit, Aktori më i mirë i dramës, Këngëtari më i mirë, Sportisti më i spikatur, Biznesmeni më i suksesshëm, Politikani i vitit, Çmimi i mirënjohjes dhe Çmimi i karrierës.



Drejtesit e këtij spektakli, moderatorët Siçiliana Mazi dhe Simon Shkreli, i uruan mirëseardhjen 500 pjesëmarrësve të ftuar në sallën e Teatrit "Migjeni" dhe telespektatorëve që po ndiqnin nëpërmjet ekranit të Digitalb edicionin e parë të "Best North 2013", të cilët po e pritnin me padurim startimin e kësaj mbrëmje vërtetë të bukur, për të nderuar me çmime personazhet më të mirë të vitit që lamë pas, ata që na emocionuan dhe na nderuan me punën e tyre gjatë gjithë vitit, jo vetëm në Shkodër, por edhe jashtë saj.

Ndjehej një kënaqësi e veçantë të shikoje gjithë ata personalitete të nderuar e të bashkuar në një mbrëmje festive kaq të bukur, një pamje e mrekullueshme që të shijonte në çdo moment të saj, me një publik artëdashës dhe figura të shquara të artit shkodran, shkrimtar, sportist, piktor, biznesmen etj., që dinë të vlerësojnë shumë mirë artin, por edhe sepse është hera e parë që organizohet në Shkodër një spektakël kaq i madh, ku jepen çmime të ndryshme, duke premtuar nga organizatorët se ky aktivitet do të kthehej në traditë vit pas viti.

Pa diskutim që ky spektakël kërkonte një organizim të madh që puna e kësaj Agjensie të dilte me sukses, pasi «Buna 1» ka organizuar 209 koncerte për 15 vite rresht, një numër rekord dhe gjithmonë i suksesshëm, por që nuk do të bëhej i mundur pa mbështetjen dhe pa besimin që pati për këtë Agjensi, Kryetari i Bashkisë së Shkodrës z.Lorenc Luka, Prefekti

e Shkodrës z.Paulin Radovani si dhe Drejtori i Teatrit "Migjeni" z. Edmond Angoni për kushtet që ata mundësuan për këtë mbrëmje magjike.

Një falenderim i veçantë ishte edhe për sponsorët «Madish sh.p.k.» dhe "Universiteti i Veriut Argenti". Nuk u la pa u falenderuar edhe skenografi Hysni Halili për punën e mrekullueshme që ai kishte bërë si dhe fonisti Fatmir Gogovi, i cili edhe pse në pension, dha mbështetjen dhe kontributin e tij profesional për këtë eveniment tepër të rëndësishëm, pa harruar "prapavijën" e këtij tempulli të mrekullueshëm.

Juria është gjithmonë vendimtare, por në këtë spektakël ishte një juri krejt e veçantë, jo e emëruar. Kush më mirë do të votonte për ta përveç publikut shkodranë.

Secili personazh i nominuar është vlerësuar në sferat e tij përkatëse, të fushës që ushtrojnë dhe mbas kandidateve, të cilat kanë qenë të afishuara në websitin [www.buna1.net](http://www.buna1.net), publiku ka votuar se kush do të jetë ai personazh që do të marrë çmimin e parë për krijimtarinë dhe kontributin e tij.



Pas shumë duartrokitjesh filloj ndarja e çmimeve, ku çmimin e parë, Shkrimtari më i mirë për vitin 2013, e fitoi Skënder Drini, të cilin ia dorëzoi Presidenti i "Universitetit të Veriut Argenti" z. Lutfi Behri.



Vijoi më pas ndarja e çmimeve për piktorin më të mirë, të cilin e fitoi Ermira Jahja dhe për ta dorëzuar këtë çmim, u ftua një person nga publiku, por mjaft i nderuar, si një personalitet i basketbollit shqiptar, z.Korab Llazani



Ndoqem më pas rradhën për çmimin e biznesmenit më të suksesshëm të vitit 2013, të cilin e meritoi z.Gjergj Liqejza. Çmimin ia dorëzoi Drejtori i Përgjithshëm i Kompanisë së Sigurimeve "Sigal, Unica Grup Austria" z.Avni Ponari.

Përmes ovacioneve, publiku i mrekullueshëm që ndodhej në sallën e Teatrit "Migjeni", me duartrokitjet e tyre të ngrohta, konfirmonin magjinë e kësaj mbrëmje të madhe.

Kështu programi vazhdoi me një pjesë tjetër të spektaklit, duke u ndaluar pak tek çmimet dhe për të ftuar në skenë një këngëtare të mrekullueshme shkodrane Rezarta Smaja, e cila përshëndeti të pranishmit në sallë dhe teleshikuesit që e ndiqnin përmes ekranit të televizionit Digitalb, me këngën "Me zemër", e cila u mirëprit nga publiku. Më pas spektakli vazhdoi në rrjedhën e vet.



Aktori më i mirë dramatik për vitin 2013 u shpall aktoria e Teatrit "Migjeni" Rita Gjeka. Për të dhënë çmimin, ftohet në skenë aktoria e mirënjohur, partneria e saj, Merita Smaja. Përmes emocioneve të mëdha, aktoria fituese kërkoi nga publiku, me humor, një gërshërë, për ta ndarë këtë çmim me kolegen e saj Meriten, dhe duke thënë se po e mbajmë këtë çmim një muaj njëra dhe një muaj tjetra.

Një ndër kulmet e kësaj mbrëmje, kur publiku po priste me padurim, ishte nominimi i aktorese së madhe shkodrane, mjeshtres së madhe të humorit shqiptar z.Zyliha Miloti, e cila meritoi nga votimi



i publikut çmimin e aktorese më të mirë të humorit, çmim të cilin nëpërmjet emocioneve të shumta, ia dorëzoi Drejtori i Teatrit "migjeni", z. Edmond Angoni.



Çmimi i radhës ishte përsëri për teatrin, që sigurisht këtë vit në Shkodër ka shkëlqyer. Regjisori më i mirë i vitit u shpall z. Fatbardh Smaja. Për të dhënë këtë çmim, në skenë u ngjit ish Drejtori i Teatrit "Migjeni", z. Lorenc Mosi, i cili ndër të tjera falenderoi edhe Agjensinë e Spektakleve "Buna 1" me President dhe Producent z.Arben Mazi që organizoi këtë mbrëmje kaq të bukur dhe plot emocione.




Hapsirën publicitare, kushtuar falenderimit të sponsorëve të spektaklit, e bënë shumë të këndshme, numri koreografik i një grupi të rinjsh, që gjithmonë, nën kujdesin e koreografit të mirënjohur, Vladimir Seiti, sjellin grintë e alegri para spektatorëve. Duhet nënvizuar se koreografi i mirënjohur Vladimir Seiti, para pak ditëve në Tiranë, fitoi çmimin e tretë në një garë mbarë nacionale e me mbi 50 grupe pjesëmarrëse.



Spektakli vijoi duke ftuar në skenë dy zonja të nderuara të qytetit të Shkodrës, Ketë Bazhdari dhe Majlinda Angoni, të cilat u nderuan me dy çmime në Tiranë, për kontributet e tyre sociale. Ato u përcollën me duartrokitje.



Radha erdhi për çmimin e sportistit më të spikatur, ku tranieri i basketbollit z.Bledar Gjeçaj, i dorëzoi çmimin sportisti më i mirë, basketbollistit të ekipit të "Vlaznisë" Gjon Ndoja.



Shkodra është burimi i zërave të mrekullueshëm, që kalojnë edhe kufijt kombëtar. Për të shpallur këngë-

tarin më të mirë të vitit 2013 dhe për t'i dhuruar çmimin e fituesit, ngjitet në skenë pedagogia e pianos z.Irena Mhilli, e cila shumë e përmalluar, shpalli fituese këngëtare e madhe shkodrane, laurate e "Voice of Italy", të mrekullueshmen Elhaida Dani.



Më pas u shpall Politikani i vitit, deputeti Agron Çela, të cilin Prefekti i Shkodrës z.Paulin Radovani e ftoi në skenë për të marrë çmimin. Z.Agron Çela, i cili i emocionuar falenderoi publikun, Agjensinë e Spektakleve "Buna 1" dhe Drejtorinë e Teatrit "Migjeni", duke thënë se të gjitha premtimet gjatë fushatës do t'i bëjmë realitet.

Për të mbajtur të ndezur atmosferën, moderatorja e këtij spektakli, e cila për herë të parë drejton një spektakël dhe skenarin e këtij spektakli ajo e ka ndër-tuar vetë, por edhe një këngëtare e re, që ka qenë pjesëmarrëse tek "Kënga Magjike" për tre vite me radhë, ajo ka arritur të dalë fituese në natën finale, ku është bërë e njohur me këngën "Xhelem, xhelem", përshëndeti këtë publik të mrekullueshëm dhe personalitet fitus me këngën "S'të fal", me tekst të Rozana Radit dhe muzika Adrian Hila.



Çmimi i mirënjohjes iu dha fotografit të paharruar Angjelin Nenshati, i cili filloi aktivitetin e tij shumë i ri. Pasioni për profesionin, dashuria për qytetin e tij, Shkodrën, përgjegjësia qytetare, e dalton personalitetin e tij. Syrit të tij nuk mund t'i shpëtonte asgjë. Në çdo ngjarje të qytetit do ishte i pranishëm me syrin e tij magjik. Krijues, plot fantazi e ndjeshmëri, objektiv i brezave të ardhshëm. Historianëve do u shërbejë thesari i tij që përbëhet nga afro 500.000 negativa, pasuri e familjes dhe e kombit. Prandaj dhe quhet thesar. Ky çmim iu dorëzua familjes

nga Presidenti dhe Producenti i "Buna 1" z. Arben Mazi, i cili në fjalën e tij e vlersoi si "Marubi e Dytë".

Magjia e kësaj nate kulmoi, kur emblema e qytetit të Shkodrës, i njohur nga krijimtaria e tij e denjë artistike, jo vetëm në Shqipëri por kudo ku jetojnë shqiptarë. Nga penda e tij e fuqishme janë shkruar shumë poezi, tregime e romane të realizuara me mjeshtri artistike. Sigurisht gjinia më e dashur e tij dhe më produktive është diçka tjetër. Drama. Veprat e tij janë fituese të dhjetra çmimeve, të vëna në skenë në Shkodër, Tiranë, Gjakovë, Prishtinë, Shkup, Tetovë, Ulqin, në diasporë, pra kudo ku ka shqiptarë. Ndër etërit e dramaturgjisë shqiptare. Jam i bindur që e kuptuat se e kam fjalën për dramaturgun e shquar Prof. Fadil Kraja. Për t'i dorëzuar çmimin e karrierës "Mjeshtrit të madh" Fadil Kraja, në skenë u ngjiti vetë Prefekti i Shkodrës z. Paulin Radovani.




Përmes emocioneve të papërshkruara e mori fjalën Pr. Fadil Kraja, i cili me mënjësinë dhe mjeshtrinë e fjalës së tij tha: "Në qershor të vitit 1945 vjen në Shkodër Ministri i Jashtëm i Bashkimit Sovjetik Ilija Ehrenburg, shkrimtar e personalitet i njohur në shkallë botërore. Erdhi në Shkodër në kërkim të dy pikturave të Rembrandit, të blera në kohën e Revolucionit të Tetorit, në Petersburg nga tregtari shkodran Mark Kakarriqi. I gjeti në fototekën e Marubit të cilën, kur e vizitoi u mahnit aq shumë nga kjo pasuri përrallore sa i tha Gegë Marubit: "Të tillë fototekë nuk e kemi as në Moskë, as në Leningrad. Gega iu përgjigj në gjuhën frënge: Zoti ministër, një proverb tek ne thotë: Në kaçubën e vogël mëshihet lepuri i madh".

Kjo kaçubë e vogël në mes të Europës, që quhet Shkodër, fsheh "lepuri të mëdhenj", ruan vlera të mëdha. Ne kemi detyrë t'i zbulojmë ato, t'ua heqim pluhurin e harresës dhe t'ua bëjmë të njohura njerëzve, për të mirë të Shkodrës dhe gjithë Atdheut.

Sivjet Teatri "Migjeni" mbush 65 vite si teatër profesionist, i dyti pas Teatrit Kombëtar. Por, gjithashtu këtë vit mbushen 127 vite nga shfaqja e dramës së parë shqipe, "Nata e Betlehemit" e arbëreshit Leonard De Martoini, 1887, si dhe 95 vjetori i daljes në skenë e së parës femër shqiptare, Roza Kakarriqi, tek drama "Erminia e vorfen" e Viktor Hygo, 1919.

Më vjen mirë që sot nderohen dy gra që ndihmojnë artin në Shkodër. Është gjë e bukur të kemi sa më shumë Mecenatë në

qytetin tonë, sepse sa më shumë njerëzit të merren me art, kulturë e sport, aq më pak do kemi drogë e kumarxhi, vjedhje e korrupsion, vrasje e terrorizëm dhe policia e gjykatat do kenë punë më pak".



Moderatorët e shkëlqyer të këtij spektakli Siçiliana Mazi dhe Simon Shkreli konfirmuan se, në këtë mbrëmje të paharrueshme kemi edhe një çmim tjetër të karriere të cilin nuk mund ta linin pa këtë çmim. I dashuruar pas sportit, objektiv në analizat e tij të thella shkencore, vëzhgues deri në detaje të të gjitha ngjarjeve sportive, mik i të gjithë sportistëve, i respektuar nga sportdashësit. Emrin e tij e njohin të gjithë shkodoranët dhe shqiptarët, kur nëpërmjet valëve të radios transmetonte me pasion, emocion dhe me objektivitet, aktivitetet sportive e sidomos ndeshjet e futbollit, i respektuar Ymer Sterniqi.

Çmimi iu dorëzua nga tranieri i mirënjohur i boksit z. Zef Gjoni. Jashtë mase i emocionuar z. Ymer tha: "Kam 52 vite para mikrofonit të Radios e Televizionit, por këto emocione nuk i kam patur asnjëherë në karrierën time, siç i kam sonte në këtë sallë. Ju falenderit!"

Qershia përmbi tortë ishte mbyllja e spektaklit, kur në skenë dolën për të përshëndetur të ftuarit, zërat e mrekullueshëm të këngëtares Mukades Çanga dhe grupit "Karaifilat që ka Shkodra", të cilët nëpërmjet një potpurie popullore shkodrane, treguan se spektakle të tilla nuk mund të organizohen pa praninë e kësaj pasurie të madhe që shoqëron evenimente të tilla. Kjo potpuri ndoshta ishte dhe urimi «natën e mirë», që ata i dhuruan spektatorëve në mënyrë melodioze, për t'i kujtuar se në këtë skenë, nuk do të mungojnë kurrë aktivitete të tilla, që shkodoranët i kanë aq shumë për zemër.

Përgatiti Ramazan Çeka

# Dekonstruksioni postmodern: roli i anakronive të rrëfimit në roman



Arjeta FERTILUSHKAJ

Rrëfimi jolinear apo fragmentarizimi nuk është tipar që u shfaq në letërsinë postmoderne sepse ka qenë i pranishëm që tek letërsia moderne. Por, mënyra se si përdoret ky "shkatërrim" i thurjes së modelit narrativ është i ndryshëm nga modernia: për hir të ironisë/parodisë (rasti i metafiksionit historiografik<sup>1</sup>) apo parimeve formale postmoderne si: double coding-u, pastich-i, ikonoklazmi etj. Kompozicioni këtu merr një rol funksional se i përket lojës me kohën sepse duke qenë i thyer dhe me paraqitje kryesisht eksperimentale ndikon në mënyrën e perceptimit të realitetit të rrëfyer në roman. Pjesa më e madhe e studuesve dhe teorianëve letrarë kanë hedhur hipotezën se në letërsinë postmoderne ka ndodhur zbehja ose në rastin më të keq, zhdukja e subjektivitetit. Shkatërrimi i këtij rendi është dekonstruksioni për rikonstruksionin por në rendin alà postmodern. Jemi më afër decentralizimit, pra mungesës së një boshti tematik e narrativ dhe mbizotëron loja me kujtesën, retrospeksioni (kthimet prapa në kohë, shpesh të papërcaktuara). Ky fragmentarizim, që e ndeshim edhe tek shkrimtari Ridvan Dibra shpreh vetëdijen poetike të autorit sepse thurja e një kompozicioni të qëndrueshëm nuk është tipar postmodern: nuk ka më vepra që ruajnë një hyrje, kullm dhe fund të historisë së rrëfyer. Nga raportet me rendit të ngjarjeve të historisë (fabula) dhe rendit të tregimit (ligjërimi narrativ)<sup>2</sup> ne mund të shohim se si realizohet në veprë loja me kohën. Në këtë punim ne na intereson koha e ligjëritimit narrativ dhe jo koha e fabulës prandaj fokusi jonë drejtohet për tek anakronitë e rrëfimit siç janë analepsa dhe prolepsa.<sup>3</sup> Tek romanet që kemi marrë në shqyrtim: "Triumfi i Gjergj Elez Alisë", "Triumfi i dytë i Gjergj Elez Alisë", "Sexonic ose Sesilja", "Franc Kafka i shkruan të birit" dhe "Stina e maceve" të shkrimtarit Ridvan Dibra, tipet e ndërthurjes së këtyre dy lëvizjeve narrative janë të ndryshme. I shohim me radhë:

**"Triumfi i Gjergj Elez Alisë":** Gjergj Elez Alia, pas nëntë vitesh ngujim në Kullën e tij të Bardhë në Egobokë, vendos të ulet në tavolinën e shkrimit dhe të na e tregojë historinë e jetës së tij. Paraqishtë, ky narrator autodiegetik<sup>4</sup> na tregon se

1 Shih: Linda Hutcheon: *A poetics of postmodernism. History, theory, fiction*. "Routledge", New York-London, 1988.

2 Shih: Gérard Genette: *Figure III. Discorso del racconto*. "Einaudi", Torino, 1976.

3 Analepsa: çdo evokim i fakteve të ndodhura të një ngjarjeje të mëparshme në raport me çastin e ligjëritimit; Prolepsa: manovër narrative që tregon ose evokon paraqishtë një fakt/ngjarje të mëtejshme. Të dyja këto lëvizje narrative i përmbledh termi anakroni, i cili shenjon të gjitha format e mospërputhjeve mes dy rendeve kohore: historisë dhe tregimit. (Shih: Gérard Genette: *Figure III*, fq. 87-88.)

4 Brenda narrativit homodiegetik, i cili është personazh në historinë e rrëfyer, Genette diferencion narratorin autodiegetik, i cili është edhe protagonist në historinë e rrëfyer. (Po aty, fq. 293.)

rrëfimi i tij do të ketë tri kohë: Kohën para Balozit, Kohën me Balozin dhe Kohën pas Balozit.<sup>5</sup> Pas disa faqesh, narratori na fut në Kohën para Balozit (analepsa) pra bën një evokim të kohës kur ai u nis në luftë dhe mori plagët që do t'i kushtonin nëntë vite ngujim: "Mbam mend nënën që qante në heshtje diku në qoshe të Kullës, ndërsa motra gërrichte fytyrën me thonj: unë isha tashmë mashkull i vetëm në familje [...] Të nesërmen, me t'u varrosur babai dhe me të ikur mysafirët, unë do të nisësha përnjëherë në luftë." (fq. 20-21) / "Ku e ndërpreva rrëfimin mbrëmë? Më duket se tek beteja ime e parë, tek plagët." (fq.25) Analepsa të tilla (të brendshme) ndeshim gjatë gjithë romanit në mënyrë të herë pas herëshme: rasti i ëndrrës me kalin e bardhë (fq.26-28), me motrën (fq.60-62), me ushtarin fytyrëbukur (fq.116-118), kujtimet nga fëmijëria (fq.38, 85) etj.

Rastet e prolepsave (apo siç i quan Umberto Eco padurimi narrativ) janë të veçanta: shfaqja e parë gjendet që në titull (parathuhet triumfi mbi Balozin) dhe rastet e tjera janë brenda analepsave të ndërfutura si dhe brenda kohës së rrëfimit (jashtë analepsave). Po japim një shembull ilustrues për secilin rast: Jemi më larg në kohë në raport me çastin e ligjëritimit të rrëfimit, pra brenda analepsës kur diferencojmë prolepsin (nënvizimi është i yni): "Unë e ndjeja kalbin në çdo çast. Jo aq tek plagët, sesa diku brenda vetes sime. Në fillim e humba dëshirën për ta parë lindjen e diellit, mandej edhe perëndimin e tij. Tamam atëherë u shfaq fati im: Baloz. Por mjaft për sonte. Një herë tjetër për Balozin." (fq. 103).

Ndodhemi në kohë të afërt me çastin e aktit të rrëfimit dhe prolepsa (nënvizimi është i yni) ndërfitet para se të hyjmë në analepsën e radhës: "Unë i thashë motrës se mes meje e Norës gjithçka kishte marrë fund tashmë [...] që s'isha në gjendje të doja dikë a diçka tjetër përveç plagëve të mia. Motra më tha vetëm "i gjori ti!" dhe iku pa më dëshiruar natën e mirë. (Që pas vdekjes së Balozit motra nuk flet në një dhomë me mua)." (fq. 58). Shumë shpejt, ndërfitet analepsa e radhës: "Tani më duhet të vazhdoj rrëfimin, kam aq shumë për të thënë. Kam shkruar me sipër, më duket, se me t'u kthyer nga lufta..." (fq. 58).

Siç vihet re, kemi evokime për periudha më të largëta se Koha me Baloz, që do të thotë se jemi në nivele të tilla narracioni: herë për kohë më të hershme se shfaqja e Balozit dhe herë për kohë më të afërta, p.sh.: nga fq.31-34 e librit, narratori autodiegetik na tregon për takimin që ka bërë dje me Norën, të fejuarën e tij. Jemi në një të kaluar më të afërt me aktin e rrëfimit. Kthime të tilla janë tepër të shpeshta në roman dhe e kaluara e protagonistit i sillen rrotull vazhdimisht dhe gjatë gjithë romanit, narratori na trondit "me një lojë marramendëse të analepsit e prolepsit."<sup>6</sup>

**"Triumfi i dytë i Gjergj Elez Alisë":** Narratori autodiegetik, ndryshe nga romani i parë ("Triumfi i Gjergj Elez Alisë"), nuk ulet të rrëfejë për histori të ndodhura shumë kohë më parë por për atë çfarë ka ndodhur me jetën e tij pak kohë pas triumfit me Balozin. Natyrën e ndryshme të rrëfimit na e thotë vetë ai: "Kisha shkruar pa asnjë qëllim. Thjeshtë për hir të shkrimit. Jo për ta rrëfyer jetën time si dikur. Por, ndoshta, prapë po gaboja në përfundimet që nxirra: ndoshta edhe kjo mënyrë e re e të shkruarit rrëfente njëfarësoj jetën time, jetën time pa plagët" (fq.180) Kështu, analepsat në roman nuk janë njësoj si tek romani i parë sepse rendi narrativ këtu paraqitet ndryshe. Nëse tek "Triumfi..." narratori autodiegetik na përcakton më qartë se kur ulet të rrëfente atë që kishte ndodhur qoftë para nëntë vitesh e qoftë pas ngujimit, tek

"Triumfi i dytë..." koha e historisë me kohën e tregimit shkojnë drejt afrimit me njëra-tjetrën. Analepsat janë më së shumti memoriale (ëndrra, ngjarje nga fëmijëria etj.) ndërsa nëse e shohim në plan të makrostrukturës (romani si teresi) mund të themi se kemi të bëjmë me një analepsë të gjatë e të hapur, e cila duket sikur zgjat deri në fund të romanit kur narratori i jep fund rrëfimit: "Ky ishte triumfi im i dytë. Ose më saktë bejlegu im i dytë me balozin. Nuk e di a do të ketë edhe një të tretë.

5 Boshti i rrëfimit është përbërja me Balozin prandaj edhe kohët janë të ndara në varësi të kësaj ngjarjeje.

6 Umberto Eco: *Gjashhtë shëtitje në pyjet e tregimtarisë*, "Dituria", Tiranë, 2007, fq. 42.

**Nëse po, do të më duhet të zgjedh të tjera armë. Ato që kam përdorur deri më tash, domethënë urrejtja dhe shpërfilla, do të jenë ndryshkur deri atëherë." (fq. 225) Pas fillimit të romanit në të tashmen: "Jam mbyllur prapë në Kullën time dhe prapë jam ulur në tryezën e shkrimit" dhe me hyrjen në analepsën e gjerë, brenda saj, në fq. 58-62 kthehem shumë më mbrapa në kohë (e shkuar brenda së shkuarës) tek historia e vrapit të Zefit: "Pleqtë e Egobokës ende rrëfejën për Zefin e Berishajve, i cili..." Pra një analepsë brenda analepsës. Një tjetër rast i kësaj analepsë është edhe sjellja e një episodi nga fëmijëria e protagonistit: "Shumë kohë më parë, kur unë ende isha fëmijë, qenë shfaqur në Egobokë disa njerëz të çuditshëm." (fq.130) Ndërsa ëndrrat e protagonistit që i rrëfen pasi i ka parë futen në rrëfim si analepsa që të hedhin në një kohë më të afërt me çastin e ligjëritimit: "Në mëngjes u zgjova i dërrmuar. [...] kisha bërë një gjumë plot ëndrra të këqija. Ajo e fundit, e cila edhe më zgjoi kishte qenë më e llahtarshme. Shëtisja i vetëm rrugëve të Egobokës..." (fq. 36-37)**

Baloz i shfaqet në Egobokë ditën që shënonte njëvjetorin e "ndeshjes" së tij me Gjergjin. Gjergji e shpërfill Balozin kur ai e fton në mënyra të ndryshme që të përballet me të, pastaj shpërfillen me njëri-tjetrin, deri në momentin kur Baloz i shkon tek dera e kullës së Gjergjit. Koha është e alternuar: herë rrefehet me të pakryerën here më të kryerën e thjeshtë për të treguar se këto ngjarje kanë ndodhur tashmë para çastit të ligjëritimit. Nëse në romanin e parë, kohët ishin më të ndara, tek ky roman kujftij kohorë janë vështirësisht të diferencueshëm sepse autori kërkon të ngatërrojë lexuesin duke luajtur me kohën. Përmes narrativit autodiegetik, ai rrefen më së shumti me të pakryerën e dëftores, ndryshe nga romani i parë kur përdorte kohën e kryer (për të folur për të kaluarën) dhe të tashmen e dëftores (për rikthimet që bëntë në kohën e rrëfimit). Zgjedhja e kësaj kohe (dhe jo p.sh. të kryerën) lidhet me natyrën hipotetike të rrëfimit që kërkon të ndërtojë autori. Sërish jemi në kohën e shkuar sepse ngjarjet që lexojmë kanë ndodhur tashmë apo mendohet se kanë ndodhur. Sa i përket prolepsave, i hetojmë në disa raste. Kur protagonist po kthehet nga krahina fqinjë ëndërron për pritjen që do t'i bëhet kur të mbërrijë por në fakt prita që i bëhet është kreu tjetër dhe zhgënjyese. Ky shembull i prolepsës së rreme na del edhe tek fjalimi që protagonistit mendon të mbajë në festën e 40-vjetorit të tij. E lexon në shtëpi para pasqyrës: "I nderuar popull trim, heroik, liridashës, i lashtë, i urtë, i besës, punëtor dhe bujar i Egobokës! (Pushim i gjatë. Turma duartroket si e dehur. I nderuar zoti Baloz! (Pushim i shkurtër. Baloz sheh me bisht të syrit nga unë dhe rreh shuplakat lehtë). [...] Fjalimi (me gjithë pushimet) kishte zgjatur gati një gjysmë ore. Jo keq. Ishte koha për t'u nisur." (fq.213-215) Pas kësaj atmosfere të pamundur nga Gjergji kur do të lexonte fjalimin, ne mësojmë më vonë se ai fjalim nuk u mbajt.

**"Franc Kafka i shkruan të birit":** Kafka, pasi i ka shkruar një letër të atit shumë vite më parë, vendos tani t'i shkruajë të birit. Në këtë letër, Kafka kujton herë pas herë momente nga fëmijëria e të birit e njëkohësisht nga rinia e tij, në mënyrë të veçantë nga marrëdhënia me të atin. Përpos kësaj, autori i letërsë i flet të birit dhe i jep këshilla për jetën, artin dhe dashurinë. Ndërsa Kafka po shkruan këtë letër, e ndërpret në mënyrë të vazhdueshme vijimësinë e saj, jo vetëm në rastet kur proçesi i shkrimit i kthehet retrospektivës (analepsa) por edhe kur ndërfitet tregime/parabola të shkruara nga Kafka fiksional. E gjithë kjo "histori" apo përvojë jete e hedhur në letër është hipotetike dhe jo e ndodhur realisht për Kafkën fiksional sepse në parathënien e letërskruarit, me titull "Nëse", ai thotë: "Nëse, që fëmijë, nuk do të isha kështu i dobët, i ndjeshëm, shëndetlig e i ndrydhur [...] nëse unë do të shërohesha e nuk do të vdisja [...] nëse pas dy fejesave të dështuara, në të tretën [...] dotë martohesha me Felicen [...] nëse Ajo [...] do të më falte edhe një djalë [...] nëse do të ndodhnin të gjitha këto, pra, atëherë, sipas të gjitha gjasave, unë, Franc Kafka, do t'i shkruaja tim biri:" (fq. 5-6).

I konceptuar kështu, atëherë mund të themi se e gjithë letra është një proleps i rremë i mundshëm. Themi i mundshëm sepse koha me të cilën

e shkruan parathënien është e tashmja e kushtores.<sup>7</sup> Nëse do të ishte shkruar në kohën e kryer të kushtores (nëse do të kishin ndodhur të gjitha këto ..., do t'i kisha shkruar tim biri), atëherë prolepsi do të ishte përfundimisht i rremë. Kjo letër hipotetike jo vetëm e argëton lexuesin por edhe e ngatërtron. Këtu luhet me enciklopedinë e lexuesit: Kafka fiksional (si autor model) prezantohet jashtëzakonisht i ngjashëm me Ridvan Dibrën (autori real) por kjo është një çështje që do të trajtohet diku tjetër. Sa i përket analepsave dhe prolepsave, ata shfaqen në brendësi të romanit në trajtë fragmentesh të shkurtra dhe janë shumë të shpeshta.

**"Sexonic ose Sesilja":** Përmes narrativit autodiegetik, në roman ne njihemi me historinë e lojës së protagonistit me Sexonin dhe Sesiljen. Protagonisti, duke u kthyer shpesh në kujtimet e lojrave të fëmijërisë, na rrëfen me pas se si u njoh me lojën elektronike me emrin Sexonic dhe studenten me emrin Sesilja. Analepsat dhe prolepsat në roman janë të brendshme dhe me sekuenca të shkurtra. Koha me të cilën rrëfen na bën të mendojmë se kjo lojë ka ndodhur para aktit të ligjëritimit: "Sexonixi u hap pa ndonjë vështirësi a rezistentë kushedi çfarë, sepse, me sa mbaj mend tashmi kur jam ulur e po shkruaj këto rrjeshta..." (fq. 66) Pas përpjekjeve dhe provave të vazhdueshme për të luajtur me Sexonin si dhe për ta shtënë në dorë studentën me emrin Sesilja, protagonisti dështon në sipërmarrjen e tij dhe dorëzohet duke shpresuar të triumfojë vetëm në ëndërr. Ndoshta për këtë arsye është përdorur kaq dendur e pakryera në roman, për t'i dhënë "gjithë ngjarjes një ton ëndërror, sikur të ishim duke parë diçka me sy gjysmë të mbyllur".<sup>8</sup>

**"Stina e maceve":** Nëse mund të flasim për subjekt tek ky roman dhe për rend ngjarjesh, do të thoshim se ngjarjet rrjedhin në mënyrë lineare në hark kohor një ditore. Nga mëngjesi i së shtunës (7 mars) e deri në mesnatë (shtunë-diel) në roman përsëritet i njëjti proces: protagonist i lexon enciklopedi shkencore/bashkëjeton me gruan/shkruan lexon temën shkencore. Këto tri procese fragmentarizohen në roman me nga dhjetë mininarracione secila. Të bashkuara, ata ndërtojnë makrostrukturën (dhe "historinë") e romanit. Rjedha e ligjëritimit në roman vijon si e padefinuar nga ana kohore por gjithësesi i kemi disa "të dhëna" që lidhen me temporalitetin e rrëfimit: "Normalisht, macja (maçoku?) jeton rreth 15 vjet... lexon BURRI (njëri ndër më të njohurit linguistë dhe sciobiologë të Egobokës) në një enciklopedi, që mban mbi prehtë." (fq. 7)

Folja "lexon" na tregon se jemi në kohën e tashme. Mënjëherë ne kalojmë në mëngjesin e së shtunës ku lexojmë: "Mbrëmë ke qenë i mreku-lueshëm. I hatashëm. Si në asnjë natë tjetër", thotë gruaja dhe, si e shkud fort burrin pranë, shtrijet përgjumshëm... (fq. 9) Kjo mënyrë të rrëfyerit ku duket sikur koha e ngjarjes dhe koha e rrëfimit janë pak a shumë e njëjta, shtrijet në pjesën më të madhe të romanit. Sipas Genette, kjo kohë tregimtare është e tipit simultan.<sup>9</sup> Efekti që krijon tek lexuesi kjo mënyrë të rrëfyerit është se e bën atë t'i duket se ajo që po lexon, është duke ndodhur pikërisht tani. Ajo çfarë përbën një risi të veçantë tek ky roman, më shumë sesa manovrat me kohën, është tek fokalizimi, por nuk është pjesë e interesit tonë në këtë punim.

Siç shihet, modeli narrativ tek pesë romanet që kemi në analizë është i ndryshëm: tek "Triumfi i Gjergj Elez Alisë", "Triumfi i dytë i Gjergj Elez Alisë" dhe "Sexonic ose Sesilja" mund të flitet për një farë subjekti që ndjek zbehtas një fillim-kullm e fund të ngjarjeve. Ndërsa, tek "Franc Kafka i shkruan të birit" dhe "Stina e maceve" nuk ndodh diçka e tillë, nuk ka një ngjarje të mirëfilltë. Kjo përzgjedhje nga ana e autorit ka vetëdije poetike. Karakteristikë e veprave postmoderne është papërcaktueshmëria e qartë e kategorisë së kohës. Pikërisht kjo krijon rendin kaotik në hapësirën simbolike (siç është Egoboka). Loja me kohën është marramendëse dhe është e lidhur ngushtë edhe me ndryshimin e fokalizatorit në rrëfim. Kjo strategji narrative përbën tiparin postmodern të ekletizmit.

7 Kuptimi i kohës së tashme të mënyrës kushtore është të tregojë një veprim, që mund të kryhet para ose pas çastit të ligjëritimit, në rast se vërtetohet një kusht i caktuar. Kurse e kryera e kushtores tregon një veprim që mund të ishte kryer në të shkuarën, po të ishte vërtetuar një kusht i dhënë. Pra, si tek kushti, si tek rezultati jemi në hapësira të mundshme, jo përfundimisht të pamundura.

8 Umberto Eco: *Gjashhtë shëtitje në pyjet e tregimtarisë*, "Dituria", Tiranë, 2007, fq. 23.

9 Gérard Genette: *Figure III. Discorso del racconto*. "Einaudi", 1976, Torino, fq. 264.



# ATA QË JETËN JA KUSHTUAN KËNGËS

Të shkruash për Dukagjinin, historitë, trimëritë, heronjtë, luftërat, gojëdhënat, për folklorin dhe për artistët që ka nxjerrë ky trull do duhej një kohë shumë e gjatë. Por unë po ndalem në zonën e Shoshit në një kullë, ku nuk munguan cilësitë e lartpërmendura. E kam fjalën për Mark Lulashin e Gurrës së Shoshit. Marku ishte i biri i Lulash Ndout, ishte një djalë i gjatë dhe serioz, guximtar, patriot dhe shumë atdhetar.

Por shumë shpejt ai do bëhej edhe një njeri shumë i rëndësishëm për Gurrën, për Shoshin dhe mbarë Dukagjinin. Me zgjuarsinë e tij prej malësori me edukatën që i dha familja dhe me një njohuri të gjerë rreth traditës, Marku do bëhej një ndër njerëzit më të kërkuar për pleqërimi dhe kuvende të rëndësishme. Kishte një pozitë, një autoritet dhe një respekt të jashtëzakonshëm nga të gjithë bashkëkohësit e tij të rëndësishëm të asaj kohe.

Mark Lulashi përveç këtyre që përmenda me lart zoti i kishte çua edhe një të mirë tjetër, ishte i martuar me një sokoleshë, me një grua zonjë, Zojë Mustafja gruaja e Mark Lulashit ishte nga Thethi, vinte nga një derë me emër, ishte një grua shumë serioze, e zgjuar, e rreptë në shumë aspekte që e rrethonin, dhe me tipare burrërore. Zojë Mustafja ashtu sikur bashkëshorti i saj edhe kjo kishte një profesion, një zanat të cilin e donte dhe e ushtronte me shumë pasion dhe dashuri. Zoja ishte vajtoje, merrte pjesë rregullisht në vajtimet e burrave, djemve, grave e çikave të Dukagjinit edhe më gjerë.

Me këtë veprimtari ajo mori një famë të madhe në të gjithë Veriun e Shqipërisë. Ajo kishte arritur një nivel shumë të lartë krijimtarie, një zë të fortë, dhe një vajtim që nuk mund të bënte kush tjetër. Zojë Mustafes gjatë karrierës së saj si vajtoje i rastisi të vajtonte shumë njerëz të rëndësishëm të Dukagjinit dhe Malësisë së Madhe. Shumë persona me peshë si, luftëtarë, dëshmorë të lirisë së atdheut dhe shumë të tjerë u vajtuan nga Zoja. Por Zojë Mustafja ishte shumë transparente dhe e rreptë, kështu që në një vajtim të një personi të vrarë nga qeveria ajo shau dhe mallkoj qeverinë me fjalë shumë të rënda, të cilat as një burrë nuk do guxonte ti thoshte.

Për këto fjalë më vonë ajo do dënohej me burg, ishte një gjë shumë e pazakontë, që një grua të dënohej me burg tamam si një

burrë. Mark Lulashi dhe Zojë Mustafja kishin 4 fëmijë, 2 djem dhe 2 vajza. Vajza e madhe Drande Markja do të martohej në Shalë, në Breg Lumi me Çun Nikën. Edhe Dranja në vitet e mëvonshme do të trashëgonte zanatin e nënës së saj si vajtoje dhe këtë zanat do ta trashëgonte më vonë tek e bija, Lulë Çunja. Duhet thënë me shumë të drejtë që të tria, si Zojë Mustafja e bija Drande Markja dhe po ashtu edhe e bija e kësaj Lulë Çunja, do të ishin dhe mbetën vajtoret me të suksesshme të Dukagjinit. Por Drande Markja nuk do ta transmetonte talentin e saj vetëm tek e bija Lula, por edhe tek djali i saj Mhilli.

Mhill Çuni me një talent të trashëguar nga nëna dhe dajati do të vazhdonte rrugën si këngëtar. Ai do shkruante tekste, do bënte muzikë, do ishte instrumentist, kështu që ja arriti të bëhej një kantautor shumë i suksesshëm. Edhe vajza e dytë Mri Markja do martohej po në Shalë, në Vuksanaj me Shpend Vocrrin. Edhe djemtë e Mrisë do merrnin nga talenti i dajave dhe gjyshes, por jo në përmasa të mëdha. Ishin instrumentistë, këngëtarë të mirë, por edhe mjeshtër veglash muzikore si çiftelia, sharkia, lahuta e të tjera. Por ata që do bënin karrierë dhe emër në kohët më vonë ishin dy djemtë e Markut dhe Zojës. Gjergj dhe Kole Marku, që do të trashëgonin më së miri aftësitë e lëna nga babai dhe kryesisht nga nëna rreth çdo gjëje që kishte të bënte me muziken. Gjergji dhe Kola do ishin ndër këngëtarët e parë të Shoshit.

Ata u morën në mënyrë të gjithanshme me artin. Gjergji, i cili ishte vëllai i madh dinte ti binte, çiftelisë, sharkisë dhe lahutës, por përveç se u binte ai ishte edhe shumë merakli në punimin e tyre. Si zanat, Gjergji ishte farkëtar, zanat ky i trashëguar nga babai i tij Marku. Por Gjergji ja gjente gjithmonë kohën për tu marr edhe me mjeshterin e drurit. Ai kishte edhe dhunti të tjera, Gjergji këndonte në mënyrë perfekte me lahutë, çifteli dhe këngë majë krahu. Dhuntitë e tij dhe të mirat që i kishte fal zoti nuk kishin të sosur. Një e mirë tjetër e tij ishte se, ai shkruante tekste. Çdo këngë e kënduar prej ti ishte e shkruar dhe e kompozuar po nga vet ai.

Edhe vëllai, Kola ishte mjaft i talentuar. Me një zanat të bukur siç ishte ai i mjeshtrit të ndertimit. Kola së bashku me babën e tij ndërtoan me qindra kulla në malet e Dukagjinit. Por mbas punës së lodhshme i a gjente gjithmonë kohën për tu marr me muzikë.



Vëllezërit Gjergj e Kole Marku

Ndryshe nga i vëllai, Kola, zgjodhi për tu marrë me dy vegla frymore, me fyell dhe me gjethë nëse dhe kjo mund të quhet vegël muzikore. Ishte ndër të parët që përdori gjethin dhe një instrumentist i talentuar në fyell. Kështu së bashku, dy vëllezërit ushtroheshin dhe bënin muzikë për vete, për miqtë e shumtë që u vinin, për shokë dhe dashamirë, për dasma dhe raste të tjera gëzimi, por më vonë edhe për të gjithë Shqipërinë. Gjergji dhe Kola do merrnin pjesë në shumë koncerte, festivale, dhe në të gjitha aktivitetet kulturore artistike. Do të ishin in-

strumentistet e parë në Shqipëri që vendosen së bashku në një melodi të përbashkët fyellin dhe çiftelinë.

Ishte një gjë që nuk e kishte bërë kush më parë. Falë këtij talenti, ata do të përfaqësonin Dukagjinin në shumë aktivitete, do merrnin pjesë shumë herë në festivalin e Gjirokastrës dhe festivale që organizoheshin në të gjithë Shqipërinë. Por këta dy vëllezërit artistë do të ftoheshin edhe jashtë shtetit për të kënduar në shtete të ndryshme. Falë talentit dhe kontributit që jepnin në art ata u vlerësuan shumë herë me dekorata dhe medalje të ndryshme. Zhvillimet politike të asaj kohe do të preknin edhe Dukagjinin, futja në kooperativë bujqësore ishte një gjë e tmerrshme dhe shume e rëndë për malësorët e këtyre maleve të thepisura. Dhe duke mos pranuar futjen në kooperativë Kola largohet nga Shoshi për tu sistemuar në qytetin e Lezhës.

Këtu vëllezërit ndahen për gjithmonë, por jo si vëllezërit, jo si shok, por nga ana artistike. Largësia nuk ja u jepte mundësinë për të vazhduar së bashku rrugën e artit, por kjo nuk i ndalte ata për tu marrë me artin. Kola i bashkohet grupit artistik të Lezhës, duke u bërë pjesë e rëndësishme e tij në çdo aktivitet që organizonte. Ndërsa Gjergji u bë udhëheqës artistik për Shoshin, duke përgatitur talentet e reja që do përfaqësonin Shoshin në koncerte të ndryshme. Por asnjëherë nuk e shmangte mundësinë për të kënduar edhe vet, për të thurur tekste të reja dhe tashme jo vetëm për vete por edhe për këngëtarë të tjerë.

Shkurtime kjo ishte biografia e një kulle Shoshi, një malësori me emër, Mark Lulashi, një grua guximtare, Zojë Mustafja, burrërore. Duhet theksuar se, ishte gruaja më e famshme e Dukagjinit, nëna e dy artistëve, Gjergj dhe Kole Marku, të cilët lanë një emër të madh dhe të mirë, një kontribut që ishte vështirë për tu dhënë në kohën e vështirë që ata jetuan. Ne e vlerësojmë, e respektojmë dhe e duam atë punë që ata bënë me shumë sakrificë. Respekt dhe mirënjohje për këtë familje dhe të gjithë ata që ruajnë dhe u trashëgojnë, brezave që vinë, traditat tona të mira.

Gjin Musa

## ... ÇOU O GJYSH ....

O Gjergj Marku o gjyshi jem sot dy fjal, un po ti them ka shumë koh jam tu menu me ty du me bisedu si Shqipnia asht katandis si ka ardh fati njerzis s' du me t' fol per politik du me t' fol gjysh per muzik se ato kang qe ti ke ba spo don kush mej nigju ma sot lahuten nuk e njohin ne vend t' saj kan fut hip - hopin si n' qytet e si n' malsi s' don ma fyell as çifteli nuk don gjeth e as zumare mej nigju po thon asht marre vegla tjera tash kan dal t' lan pa men e t' lan pa fjal ska ma mir e t' lumet na

me kompjuter bahet gjithçka kno sa t' dush si çut si fjet ta ban zanin si t' dush vet veç rrah paret n' tavolin e t' mlon kompjuteri çdo gabim tan kangtar mor gjysh jan ba ç' asht muzika nuk din gja del me knu po turp me nie si me ken tu bertit dhive as per veshje ske ç' me ju pa turpi e marrja kjoft per ta ska ma tirq, as xhamadan sot n' butik vishen te tan z' ban vaki me u pa xhubleta vishen çikat n' tesha t' leta ba me pyt, thot jam kangtare lakuriq e si vjen marre n' ka ana tjere e n' minifun a thu tjera s' kish gjet kun del me knu n' televizor si prostitut ne semafor edhe pap n' mujsh me m' nigju diçka prap kam me t' kallxu asht ba gjithkush kompozitor e s' kan mor gjysh as 8 klas shkoll kompozitor vetit i thot

e vjell muziken neper bot vjell muzik te Italiani vjedh te Greku e Gjermani veç se n' tekst jan tjera fjal se mej muzik knojn 3 kangtar e n' at tekst t' shkret s' ke ç'a me nie deri sa shahen me rop shpie kjo asht kanga gjysh, kjo asht muzika dom me u ba si Amerika po m' vjen marre me t' kallxu si zezakt kem nis me knu tekst - muzik e futja kot e ja kan vu emnin hip - hop çou o gjysh e dil prej vorri bastardhue asht folklori s' po ban kush ma festivale e kan harru muziken e t' parve ato kang qe ju i thurt vet dal - ngadal po shknoj tuj tret kangt e Mujit e Halilit kangt e trimave te Dukagjinit kangt e amla te dashnis kangt e bukura te Shqiptaris e di gjysh t' merzita pak po me t' kallxu kam pas marak e ti fort mos u merzit



se shumë shpejt do t' vin një dit e po t' baj be pasha kta krye kangve t' vjetra kan me ju kthye kan mej lyp mej knu me mall pak pa dek kan mej ringjall gjysh t' merzita me kto fjal por ta jap fjalën se sa t' jem gjall se me aq sa t' kem muni do t' shkruj vargje siç ke shkrujt ti e punen tane kam me vlersue gjithmon gjysh kam me t' kujtue!

NIKOLIN GURI

# Zona e Temal-Dushmanit

## (DISA VEÇORI HISTORIKE)



Përgatiti Mjeku Ndue K. Nikaj

Siç është shprehur më parë tek veçorit Shllakut edhe Temal-Dushmani bën pjesë në zonën e Dukagjinit, që sipas deklarimeve të historianëve të ndryshëm merr këtë emër aty nga vitet 1281. I pari i kësaj principate ka qenë Gjin Tanushi. Për merita në përfitim të princit Justinian të BIZANTIT iu dha titulli “DUKE” (Ducam Ginum Tanischum) dhe ky titull me kohën i kaloi si mbiemër familjes dhe më vonë gjithë krahinave, me përfaqësuesin më në të Lek Dukagjinin (1416-1481). Po ashtu rreth vitit 1479 pasi i kaloi nga zotrimi i Venedikut kështjella “Rozafat” e Shkodres iu dorëzua perandorisë Turke, pas dështimit me turp të Mehmetit të II-të (dytë). Në Shkodër turqit nuk mbajtën premtimet dhe bënë batërdinë, nuk mbeti këmbë i të krishterit: shumica me ndihmën e Venedikut morën ç’ka mundën dhe kaluan me denamë (anije) në Itali dhe në vende të tjera të botës, disa morën malet. Në këtë kohë mendohet, sipas gojë-dhanës, por dhe të dhënave historike u çvendos nga shqiptarët e Tuzit i quajtur Ajli TUZI. I cili u vendos fillimisht në “Qafe Tervesa”, në Qerret të Temalit. Aty atij i lindën tre djem: Doç Alia (nga ku fomohen Vila dhe Qerreti), Mark Alia (Tejluma) dhe Kole Alia (Arra)

Pas përmbajtjes së Qerretit (vjen nga fjala “Qarr-lloj lisi”, sepse aty ishte një Qarr i stërmadh i pa parë, që përmendej nga gjithë kalimtarët), u kalu në fshatin Vile fshati i parisë së Zonës, ku aty qëndron vetë Ali Tuzi me djalin e madh Doçin, ndërsa të dy djem zënë vend- Marku në Telumë dhe Kola në Arrë.

Ali Tuzit nga djali i madh (Doçi) i lindin dy djem: Lek Doç Alia (VILA) dhe Ndre Doç Alia (Qarreti). Kështu pra, kemi Vila, që mbetet si bazë e vëllait të madh dhe kryeparia e zonës, ndërsa pas pushimit të përmbajtjes dhe pushimit të tokës Ndre Doç Alia zbret përsëri në zanafillë, në Qarret. E gjithë zona e Temalit deri në vitet 1960 kanë shkuar me Dukagjinin. Pas kolektivizimit, në 1967 fillimisht pati dy kooperativa Shllak e Temal-Dushman dhe një Këshill i Bashkuar me Shllakun, me gjendje Civile në MES të Postribës dhe ka vazhduar kështu deri në vitet e demokracisë. Tani Komuna e Temalit përveç Dushmanit që tradicionalisht kanë qenë së bashke i aneksohen dhe Toplana dhe Komani (ardhur nga Puka në kohën e H/C Komani, në vitin 1978).

Tani të analizojmë një për një fshatrat e Temalit (përtej malit Cukal). Pra, vetë emri Temal, rrjedh nga përtej malit Cukal (tej-malit).

**Qarret** (Qerret) – sipas gojëdhënës vjen nga fjala “Qarr” dhe jo “Qerr” sepse qarret nuk janë përdorur në atë terren, në atë kohë flitet se qerre janë përdorur vetëm në fshatit Gushtë.

Qerreti i Temalit ishte zanafilla e zonës Temalit dhe përbahej prej tre lagjesh: Qerreti i poshtëm (Marsholli), Qerreti i epërm dhe Mal-guni. Të tre lagjet kanë prejardhje nga Ndre Doç Ajli Tuzi, vëlla me Lek Doç Ajli Tuzi (vëllai i madh) prej ku rrjedh fshati Vilë. Qerreti ka tre vëllazni: **Mem Ndreu**, prej ku rrjedhin Gjon Memajt dhe Gjon Vataj – shtë-

pia e Kol Zef Palit, e Pjeter Ndojes dhe e Ndue Marash Koles. Çek Ndreu: Ndue Mark Hajdari, Kole Prendush Nika, Gjon Prendushi dhe Mark e Simon Gjoni (Larguar heret ne Shkoder- sot është Gjergj Marku me te birin Edi). **Gjin Ndreu**, i cili pati 5 (pese) djem: Uc (kuc) gjini ku rrjedhin Kucajt – Mark Uci (Pjeter Zefdeda me vllazer – Nik Uci-Zef e Mark Bashota dhe Ndue Luka (dal fare si meshuj ne curr të mal-gunit).

Vuk – uci- Gjon e Ndoc Nik Mhilli

**Gjon Gjinajt** – ku rrjedhin Zef e Mark, Gjon Mark Deda dhe Pashuk e **Gjeç Gjini** – ku rrjedhin Zef Mark Prela (Mark Zefi me vllazer) dhe Martin Jak Vuka (Lek Martini). **Lush Gjini** – ku rrjedhin familja e Zef Kole Marashit (Kole e Ndoc Zefi e Ndue Kol Marashit, Marku me të bijt) dhe Pal pjeteri.

Qerreti ka patur burra te degjuar dhe trima si: Mhill Pali e Kol Zef Pali, Çun Toma e Ndue Marashi, Jak Vuka, Kol Bashota e Mark Bashota, Ndue Lek Dema djali pas bajraktarit dhe me vone pas çlirimt ka patur kuadro me emer si: Pjeter Zef Mandi, Mark Ndue Kola deri dhe Deputet ne Kuvendin popullor Ndoc Zef Bashota (dhe Kryetar i Këshillit Bashkuar të Shllak-Temalit);

**Vila** (Vjen ngaqë Luli i Kryeparise, ishte i degjuar në gjithë fshatrat e krahinat, si i hedhur, kalerus dhe shpatar i zoti dhe pati ndër-tuar një shtëpi të madhe, ku mbledheshin shpesh paria dhe bënin pleqrite, per kete mbeti emri “Vile”. Madje, Luli arrin deri aty sa të marrin një nuse nga një derë e madhe e Shkodres, mbesën e “Vlashajve”, qe e ndihmoje te behet dhe më i degjuar, gjë për të cilën shkrimtari e degjuar dhe heroi nacional, Pashko Vasa i dedikon romanin e parë shqiptar, të botuar fillimisht në 1882 në frengjisht me emrin “**Bardha e Temalit**”, ne te cilin përshkruhen të gjitha cilësit e Lulit Kryepari i Temalit si: i pashëm, trim, krenar, sqimtar dhe i rrembyer, por i prituar ku-bukë e kripën e zjarmin në votër nuk ia kurseu askujt. Aty beheshin pleurit, jo vetëm për Shllak e Temal, por deri për zona të largëta Gjakovë-Pejë, ku Luli ishte bërë i degjuar për thymjen e disa kryengritjeve me trimat e tij. Ai gjithnjë mbante gati në zonë 300 djem të ri, të shpejtë dhe të fuqishëm, lëvizte aty ku e kërkonin pashallar të ndryshëm për të vendosur rend dhe për këtë merrte para dhe gjysmën e plaçkitjeve që u vendosnin për eksponentet kryengritës.

Vila përbëhet nga disa lagje sot si: Saraç, Pjetrushët, Ndokaj dhe Gjon Gjeçajt... por baza e fshatit përbëhet nga Ndokajt dhe Gjon Gjeçajt. Shtëpia e parë e quajtur Vojvoda, ka qenë shtëpia e Nik Mhill Nikes, ndërsa Bajraktari ka qenë tek Marsh Pecë më në të djali i tij, Luli. Gjatë periudhës së pas çlirimt ka pasur Kryetar dhe nen/Kryetar të Këshillit të Bashkuar Ded Mark Vocri, i cili pati mbaruar shkollë pedagogjike ne Elbasan.

**Teluma** (emri vjen nga që është përtej lumit të Vilës). Teluma është e prejardhur nga Mark Ali Tuzi (Vella me Vile, Qerret e Arrë). Është një fshat i shtrire për gjatë një kodre, të veshur pak me shkurrë, dallohet për gështenja, ka pak ujë. Përbëhet nga lagjet: Markonaj (Brushtull), Teluma e Epërme (Koder Voes) dhe Teluma Poshtme.

Aty ka pasur burra trima si, Lek Çama, Zef Kol Prendushi, Gjergj Martini, Ded Mhilli. Teluma është vendlindja e shkrimtarit të madh modern hermetik, Martin Kol Cama, sot Nderi i Kombit, i cili e kaloi gjithë jetën dhe veprimtarin e tij në lard atdheut, herë në Jugosllave e Itali dhe së fundi jetoi në Muni dhe nuk arriti të shihte Shqipërinë, për të cilën punoi me mish me shpirt, gjithë jetën e tij.

**Arra**, ky emer vjen, se në këtë fshat ka pasur dhe ka një pyll arrash. Ajo e ka prejardhjen prej kole Ajli Tuzi; ka qenë një fshat i mirë me prodhimtari të mirë për tokën që ka pasur dhe ka ujë; përbëhej nga lagja e **Bregut Drinit.**, Mark Kole Preka një burri i prituar dhe me za, që kishte një shtëpi të madhe; Ndue

e Ndoc Ndreca, Kol Martin Pezria me vllazer, Sokol Mirashi, Luk e Shuk Ndoja. Lagja **Garraj**: Prel e Mark Nika, Zef e Marsh Mhilli dhe Lagja Gjon Ndedaj: Jak Ndoci (Mark e Ndue Jaku), Ndre Luka e Pjeter Luka, dhe përtej kodre e Koder Gurre (Zef Mirashi, Vuksan Marku, Lush Ndue Marku dhe Gjon Toma (Ndue e Jak Gjoni), Prendush Ndoja (Pal Guri).

Sipas pemës gjenealogjike, Temali në gjithë fshatrat e veta lidhet në brezin e X-XI tek Ajli Tuzi si më poshtë: Për Vilën-nga shtëpi e parë (Vojvoda), Nik Mhill Nika: Ndoci, Milli, Nika, Mhilli, Nika, Marku, Buçi, Meshi, Gjoni, Leka, Doçi, Ali-Tuzi.

Përsëri tek Zef Marsh Nika: Frani, Zefi, Marshi, Nika, Mhilli, Vuka, Marku, Gega, Meshi, Gjoni, Leka, Doçi; Ali – Tuzi.

Për Qerretin vella me vilen si më poshtë: për shtëpin e pare (Vojvoda) e Ndue Marashit: Toma; Marku, Ndue, Marshi, Kola, Gjoni, Vata, Gjoni, Mema, Ndreu, Doçi, Ali – Tuzi. Po këtu, familja e Kol Zefit: Sokoli, Marku, Kola, Zefi, Pali, Pjeteri, Deda, Gjoni, Mema, Ndreu, Doçi, Ali – Tuzi. Po ashtu per Çekjt (Kol Nika e Prendush Nika)-Justini, Ndoja, Kola, Nika, Leka, Dema; Pjeteri, Marku, Çeka, Ndreu, Doçi; Ali – Tuzi. Per Telume takohen tek Mark Ali Tuzi dhe Arra tek Kol – Ali Tuzi;

**Dushmani (Nalet, dreq, armik)**

Është një zonë e veçantë në periferi të Temalit (sipas gojë-dhenës nip i bijës së Temalit ardhur nga Thaçi i Iballe-Puke që dhe ata kanë ardhur nga Thaçi afër Pejë-Gjakoves. Nga ana historike, vetë Thaçi i Pukes kishte ardhur nga Peja aty nga vitet 1480, në kohën, kur u bënë levizjet e medha nga dhuna qe ushtroi perandoria turke ndaj viseve shqiptare kudo ishin, pra kur erdhen te paret e Shllakut, Temalit, Toplanes e te tjere. Ku fillimisht i Thaçi është vendosur në Berishë dhe ka lëvizur, drejt në lballë e Bugjon. Historikisht sipas Nopçes, Durham e te tjere, fisi i Dushmanit filloi të hapet në fisin e Viles (Temalit) aty nga vitet 1620, pra pas një shekulli, ku Temali ishte vendosur dhe ndare ne pjesen e vet. Madje i pari i Dushmanit (Nip i bijes se Temalit martuar ne lballë) lejohet nga dajat e tij të vendtoet aty ku sot është katundi i Kishës (Dushmani fillestar). Thuhet se, në atë kohë aty kishte dhe të tjerë të fisit Luma-Bardhi (mendohet të paret fisit Toplanë, kishin ardhur kur u ndanë me Shllakun). Sipas zakoneve të asaj kohe dhe bestytive rituale; kur vinte një banor i ri duhej ti shihej si i shkon tymi i Oxhakut në mjes, po të kalone drejt, lart për-pjetë, ato ishin të pa rrezikshëm, ndërsa po të ulej poshtë si një mjegull dhe të mbulonte tokën paraqiste rrezik dhe duhej ti lëshohej vendi. Për Dushmanin ndodhi varjanti i dytë dhe LumaBardhi u shpërngul dhe sot e asaj dite vazhdoi të zhvillohet fisi i Dushmanit. Madje dhe emrin, sipas gojëdhënës ia vendosi daja i tij, Mark Alia (fisi i Telumës), i cili kur u sëmur në momentet e fundit të jetës e kërkoi për ta parë dhe lene disa porosi për kufijt e shtrirjes së tyre në të ardhmen, por ai nuk erdhi -: në sy të fisit të vet thote: a nuk më ardhni ai...“Dushman-Dushmani? Nalet – naleti” (dreq-shejtan) dhe që atëherë i mbeti si llagip gjithë fisit deri në ditë e sotme. Pra, ky emer nuk ka asnjë lidhje me emrat e përveçëm “Dussus” dhe “Man” të vitit 1319, sepse hitorikisht në vitet 1403 ka qenë përjetuar “Damianus Dussmanus”, në kohën kur fisi i Dushmanit nuk ishte as si Thaçi në lballë, e jo më të përhapje në fisin e vilës (Temalit), gjë që historikisht shprehet nga shumë shkrime se ka ndodhur pas një shekulli të vendosjes e të ndarje së fisit të Temalit, rreth vitit 1610 siç u shpreha më sipër.

Fisi i Dushmanit u shtua shumë dhe që në fillim kërkoi herë pas here dhe deri në ditë e sotme të merrte parinë e Bajraktarlekun, duke përdorur propogande e ndërhyrje me përfaqesues të bajrakeve shefitar dhe deri duke paguar shkrimtar për deformime të historisë, por historia është shkruar me gjak dhe

bajraku është marrur dhe ruajtur me luftë (me shpatë). Në fillim këto zëra i mbyti pa zhurmë, vetëm organizimi e luftimet deri në Pejë e Gjakove (Deçan) pasardhsi i bajraktarit “Luli i Bajraktari) siç njihet. Tani të analizojmë Dushmanin me fshatrat përbërse të sotëm. Aai është në periferi të Temalit i kufizuar me Telumë e Arre. Ai përbëhet nga katër lagje: Malagji, Kajvadh, kllogjen dhe vetë Dushmani i vjetër (sot katundi Kishe)

**Malagji** (I vendosur në gji malit të Cikokut dhe të Zhbenit), ka lagjet Fuske, Zhben, Ripe, Dajcajt: këtu ka patur burra të fortë e të mençur si: Kol Lulash Dema, Kol Mrashi, e te tjere. Këtu ishte vendlindja e aktorit të madh Pjetër Gjoka, po ashtu e Shqiptaro Amerikanit Santa Roza të Kalifornisë – Toni Ndoj Prendi, me te bijën Tereza Ndoj Prendi ,shkenctare ne Bilogji, po ashtu e ish Kryetarit të Komitetit Ekzekutiv te Tiranes, Ndue Marashi. Po ashtu njihen – Sokol Bala, Kole Lushi, Nike Vuksani e te tjere.

**Kajvadh** (vjen ngaqë heret kau vret një djali të ri në vath dhe e mbyti), atëherë transformohet kau-vath- në kajvadh. Të tjerë theksojnë se e ema djalit e kishte emrin “Kaje” – pra i mbyti kau i kajes djalin në vath.

**Klllogjen** (vjen nga fakti se ishte një fshat i pasur me ujë me shumë bagëti – fillonte një miser shumë i bukur dhe i zhvilluar mirë, por e kapte një semundje që i prishte kallirin duke e kthyer në klllogjen (një si e zezë, në vend të kallirit – dhe nuk prodhonte asgjë). Në Klllogjen dallohen fiset e Volajve (Prendaj), Selimajt a te tjere;


Nga me të ndigjuarit ka qenë Gjok Vocri (i Volajve) – të cilët kane qene shume puntor dhe shtepi e prituar – ato kane zene vend ne Shkoder, ku kane një shtypshkronje me emrin “Volaj”. Po ashtu Selimajt – Martin Kol Marashi e Pjeter Kol Marashi kane qene burra ne za, Ndue Pal Selimi me kush-trinjt e vet: Vogel e Market Zefi, kane qene vendos qe heret ne Shkoder. Nga me te degjuarit kane qene Zef Pal Ndue Selimi (me tre djem e tij ne Amerike). Sokoli ka patur nje djali, Paulin Sokol Pal Selimi, i cili ka shkruar shume per humorin shkodrar. Po ashtu ne Klllogjen jane njohur Kol Pjeter Selimi, Gjon Frroku, Ndue Marsh Thana, i cili ka jetuar ne Belgjike, Cam Dedoshi e te tjere. Katundi i Kishes (i mbeti emri, pasi Dushmani që heret ngriti kërkesë për të marrur parinë u vendos që Kisha e zones te vendoset ne Dushman) dhe qe nga ajo kohe u quajt katundi i Kishës). Perbehet prej disa lagjeve: Shtotri (sot i përmbytur nga liqeni i HC/ Komani). Aty kane qenë Kol Ded Shtotri dhe Pjeter Ded Shtotri (sot ne Ranza Bushat), Çun Mhilli (i cili nuk ka lene djali, veç djem te gruas se dyte, Mark e Ded Mhill Kola: - Vrishti: Kole Mhilli me djem – Zefi, Ndoci e Gjergji e te tjere. Peplekajt :- Kole Gjergji e Pjeter Gjergji me familjet e tyre. Qendra e fshatit – Kin Mhilli, Ndue Mhilli, Kol Ndreka; Mirash Pal Ndoja e te tjere. Paja – Lazer Pal Uka, Ndoc Pal Uka, Marsh Ndoja, Kin Kroni e te tjere. Nga fshati i Kishe Arren, ka preja rdhjen dhe familja De-ilja, dhe nder ta veçohet piktori i madh, Lin Delija, Nderi i Kombit. Nga ana Gjeneralogjike Dushmani përbëhet nga 3 (tre) vëllazeri: Pap Memaj – Malagji – Fuska e shbeni e ripajt dhe Peplekajt e Kishes, Kol Mema – Kajvadh; Çek Memaj (Dajcajt – Malagji – Paja – kishe dhe një pjesë Klllogjen), por megjithë hulumtimet e bëra dhe studimet që kemi arrit të lexojmë nuk gjejmë mundësi të arrijmë në më tepër se 6-7 brez nga më i riu tek më i vjetri.

ME Ndërtimit e H/C Komani shumë familje të Kishe Arre, i përmbyti liqeni dhe janë larguar në zona Fushore si, ne Ranza Bushat, Oblike; por ky liqen solli një përmbirëim të levizjeve me anë të varkave, anijeve e deri te Tragetit, sepse zona e Temal-Dushmanit nuk ka asnjë rrugë që përshkon, vetëm deri në Cukal.

Tani, në vitet e Demokracisë, Komunës së Temali iu është anaksuar dhe Komani (ardhur nga Puka), por që si popullsi është ilire e romanizuar dhe me keshjtllen e degjuar të Dalmacisë. Po ashtu dhe Toplana, që ka qenë me Komunën e Shoshit, por që në fakt është vëlla me shllakun, fisi Vasejovic.

# Disidencja si idhujtari pa krena

**“SA MË SHUMË RESPEKT NDAJ NJERIUT, AQ MË SHUMË KËRKESA NDAJ TIJ”**  
**MAKARENKO**



Nga Kadri Ujka, kritik

Nëse ka koncept apo term, me të cilin është spekular gjatë dekadave të fundit, deri në shtjetësime ekstreme, brenda qenies, ky është koncepti apo termi disident, disidencë. Në vështrimin estetiko-filozofik “disident është ai që mospajtueshmërinë e tij me politikën e shtetit totalitar në lëmin e arteve, dhe me politikën e tij në përgjithësi, e ka shprehur me një veprim publik, të njohur nga të gjithë, me shkrim apo me gojë.

Madje as krijimi i veprave me dykuptimësi apo me nëntekst, qoftë ky edhe i qartë, por që nuk trajtojnë probleme të realitetit, të vendit të autorit, e që, tek e fundit, janë lejuar të botohen, nuk mund të quhet disidencë” (Fjalori i Estetikës, fq. 78-79).

E shtroj këtë, sepse gjatë dy dekadave të fundit, mjerisht, u konstatuan tentativa për t’u trukuar si disident, me arsyetime nga më pa personalitet, sofizma apo paralogjizma, një skandal sui-generis shqiptar, të inkurajuara, gjithnjë, edhe nga interesat politike të ditës. Disidencja nuk është kollare, që dikush mund ta varin në qafë, në kontekstin e ndjesive sentimentale, raporteve personale, preferencave politike, lidhjeve farefisnore aq më pak si produkt i sofizmave ku arsyetimi i rremë nuk vjen i vullnetshëm apo i paralogjizmave ku arsyetimi i gabuar zhvillohet me besimin se po arsyetohet drejt.

Disidencja është një sjellje estetiko-filozofike e krijuesit, sa me vetveten, sa me shoqërinë zyrtare të kohës, ndryshe është sfida e fjalës si gjetje estetiko-filozofike, sugjerim së brendshmi, përballë fjalës si skemë, si këshillë, apo si porosi së jashtmi. Duke e njohur prej shumë vitesh shkrimtarin Skënder Drini, “Njeriun gjigant” që “Vret tradhtinë”, “Eklipson hënën”, “Shemb idhuj”, jeton mes dy kohëve, pushon në ishujt e qetë dhe përfundimisht ikën larg në shkretëtirën e Australisë, ku takon një autor binjak të tijin, korbin”, sipas Fatmir Mingulit, ndryshe recensuesit të romanit postmodern “Korbi” të z. Drini, u befasoja nga tautologjia “kritike”: “I fundmi i disidentëve” me autor z. Zija Vukaj (Gazeta “Telegraf”, 18. 12. 2013 dhe revista “Fjala”, janar 2014).

Dhe shumë më tepër se sa konteksti tautologjik i shkrimit në fjalë i përkthyesit të nderuar Z. Vukaj, në fund të fundit, thjeshtë, një dashamirësi e autorit, më habiti heshtja e Skënder Drinit, konformizmi i tij publik me një retorikë si trukdisidencë. Këtë e pohoj, jo thjeshtë, se njoh mirë krijimtarinë e tij letrare, por edhe si njëri nga ata që kam vlerësuar veprën e tij duke lobuar me sukses në kongreset e LSHA-as të Shqipërisë, për ta zgjedhur në kryesinë e Saj. Po ashtu, me respektin ndaj krijuesit, në të parin cikël televiziv në TV-Shkodra, “Me qytetarët e Republikës së letrave shqipe”, qershor 2000, do të ishte ndër të ftuarit e mi të parë, pavarësisht se z. Drini u

shmgang kësaj daljeje publike.

Krejt ndryshe vepruan krijues të tjerë të mirënjohur si: “Mjeshtri i Madh” Fadil Kraja, dramaturgu liberal Fadil Paçرامي, kolosi i belkantos shqiptare, “Nderi i Kombit” Lukë Kaçaj e te tjere. e te tjere deri tek gjeniu i letrave shqipe, akademiku Dritëro Agolli “Nderi i Kombit”. Ndërsa po lexoja, shkrimin “I fundmi i disidentëve” të z. Vukajt, i rebeluar në ekstrem ndaj “komshinjve të letërsisë”, moralkulluar, që qenkanë kujdesur me përkushtim jashtëletrar t’i tregojnë vendin këtij heretiku (lexo S. Drinit), të cilit vepra e tij “Shembja e idhujve” na i paska sjellur mallkimin(!?!), m’u kujtua pozicioni dinjitoz i Drinit përballë vetvetes, Shkodrës së tij, që e ndjen në gjithë qenien e vet si një dhimbje sui-generis: “Shkodra djepi i kulturës, djepi i kësaj dhe asaj ka mbetur fëmija në djep: E fikme, e morëm në qafë këtë qytet duke e mbrojtur me histori si një nga maskat që u vënë në fytyrë atyre që do t’i ekzekutojnë për të mos parë flakën e plumbave. Ku janë trimat sot? Si nuk e kupton kjo Shkodra që po fiket pak nga pak me sytë e mbyllur?”

Tani kujt t’i besojmë?!? Përkushtimit jashtëletrar të “komshinjve të letërsisë”, që s’ka pse të jetë vlerë shqetësuese për asnjë krijues, paçka se paska shqetësuar qytetarin Vukaj, ndryshe një përkushtim që të sjellë ndërmend kakofoninë-thashethemnajë të plakave të rrjedhura tek filmi i shkëlqyer shqiptar “Përrallë nga e kaluara”, apo t’u besojmë dedukcioneve serioze, të sipërcituara, të S. Drinit, që s’u heq dot asnjë presë për Shkodrën tonë, me kaq e aq krijues zënderuar, me kaq e aq universitete, me Teatrin zulmëmadh “Migjeni”, me Fototekën “Marubi”, po ashtu me Seminarin shkencor ndërkombëtar “Shkodra në shekuj”, integrues vlerash nga e gjithë bota shqiptare e te tjere, e te tjere, ndërsa po shohim të bien një nga një “kështjellat” mbartëse të identitetit kulturor shkodran: Shtëpia e L. Gurakuqit, ajo e Migjenit, V. Pashës, R. Sokolit, e te tjere, e te tjere. Madje tragjikomikja s’ka të sosur: Ky metropol “qytet-shtet” s’ka akoma një media të shkruar, “originale”, të vetën çka vjen si një kompromentim publik i frymës së dyshimit metodik, si një sjellje anakronike, krejt folklorike me vetveten, së cilës i shtohet, edhe këndvështrimi provokues, tautologjik “I fundmi i disidentëve” i Vukajt, kur kujton se, titujt “shqetësues” që akordojnë, në ditët tona, parlamentet lokale, përgjithësisht, na kujtojnë “Sulmues”-it e viteve 60-të, që u “akordoheshin” aksionistëve sipas modelit të Revolucionit kulturor kinez. Përgjigja vjen shumë e qartë: Në asnjë kohë, as si i pari, as si i fundmi, në asnjë moment të jetës së tij, Skënder Drini, po aq sa nuk qe disident, në të kundërtën nuk do të arrinte të gëzojë edhe lejen krijuese gjatë periudhës 1982-1991, po aq askush, as vetë shkrimtari nuk kanë asnjë arsye të humbasin kohën brenda vetes me shqetësime të llojit e “mori, apo nuk e mori “sulmues”-in, z. Drini. (!?!).

Autori i 15 romaneve, filluar nga viti 1967, po ashtu edhe autor i mjaft titujve me tregime, letërsi për fëmijë si shkrimtar i realizmit socialist”, kryetari i LSHA-as për Shkodrën deri në funddhjetor 2013, “Laurat i Çmimit të Republikës”, z. Drini duhet të refuzonte publikisht një shkrim të tillë, si paralogjizëm, të cilin, sikur s’dua ta besoj si sofizëm-produkt i subshciencës së tij, jo thjeshtë nga ana profesionale, por edhe morale, viktimë e së cilës të ketë rënë autori i konstruktit tautologjik “I fundmi i disidentëve”- jo rekuem për Skënder Drinin.

Pse, mund të pyes lexuesi?!? “Komshinjte e letërsisë” dhe komuniteti krijues nuk ia kanë shmangur asnjë rast nderimin e merituar, shkrimtarit Skënder Drini, edhe pse LSHA-ve në Shkodër do të heshhte në vitet “90-të, kur hidhej në pension, politikisht, kritiku letrar, intelektual i shquar shkodran, Doktor i shkencave filologjike, z. Neki Lezha apo studiuesi i shquar i Konicës dhe i De Radës, njëri nga albanologët më të spikatur, Prof. Dr. Jup Kastrati

që në vitin 1962, së bashku me Prof. Vehbi Balën, tentuan të kthejnë mes nesh Fishtën dhe Konicën. E njëjta sjellje, mjerane, ndaj jetës së Frederik Reshpjes, i mbetur në fatet e heronjve të Dikensit, dhe po aq edhe gjatë ceremonisë mortore të Tij, përballë cinizmit të autoriteteve lokale, të disidentit shkodran, njërit prej poetëve tanë, elitarë:

Heshtja mjerane ndaj fatit tragjikomik, jo vetëm të monumentit të Migjenit, të kthyer në një mjedis urinimi deri në vitin 2010, sikur heshtja ndaj anonimatis akademik deri në “degdisje bashkëkohore” në Kukël e Mjedës, ironia monumentale me monumentin anonim të Fishtës, sfidimi injorues nga ndërtime përreth Teatrit “Migjeni” apo statusi ekonomik, mjeran, i aktorëve brilantë të “Migjeni”-it, është cinizmi më i madh ndaj vlerave kulturore të Shkodrës. “Sa më shumë respekt ndaj njeriut, aq më shumë kërkesa ndaj tij!”,-thoshte pedagogu i shquar, rus i përmasave botërore, Makarenko.

Asnjë përvjetor i personaliteteve të botës letrare shkodrane nuk ka pasur sensibilizimin e kryetarit të LSHA-ve të Shkodrës, pa u ndalur tek një dalje, aspak profesionale, në emisionin “Hapur” në TV-Shkodra, në 100-Vjetorin e lindjes së Migjenit, ndërsa poeti po rikthehej në Shkodër, pas 20 vitesh në anonimatis akademik. Në këtë kontekst të hidhur, konformizmi si heshtje, gjithnjë heshtje, nën kompleksin totalitar të “mosnxirjes së realitetit demokratik”, ka pasur në ballë shembullin e shkëlqyer të indifferencës intelektuale, nën klimën e boshtit ideologjik blu, aq sa, sot, të gjithëve na bën t’i shohim kokëulur, brenda vetes, dy dekadat që lamë pas, nëse ndihemi vërtet shkodranë. Ndërkohë se si më erdhi ndërmend Luixhi, “heroi” kryesor i tregimit “Plaku budalla” i A. Moravisë, përkthim elegant i Zija Vukajt, ku nën trysinë e “kokës së brendshme”, subshciencës së tij, Luixhi po injoronte “kokën e jashtme”, të vërtetën, plakjen e tij, përballë Jolës së re, dinjitoze në sjelljen ndaj një plaku budalla si Luixhi, “baba” apo “gjysh” për këtë vajzë, por kurrsesi dashnor i mundshëm...

Çudia me fatin prej “heretiku” të Drinit, sipas konstruktit tautologjik, “I fundmi i disidentëve” nuk ka të sosur: Madje, ironia kulmon aq keqas sa që mallkimi i sjelljes së “komshinjve të letërsisë”, apo i një këshilli lokal ndaj Drinit, na ofrohet si analogji, ruajta, zot apo reminishencë me fatin e Selman Ruzhdijes dhe po aq me statusin etikofilozofik të Diogjenit antik, që si “përbuzje” ndaj njerëzimit strohohet në një fuçi dhe, “në mbrojtje të hises së tij të diellit”, dilte në mes të ditës, rrugëve të Athinës me një llampë në dorë duke thënë: “Po kërkoj një njeri” (D. Zhyllia “Fjalori i filozofisë”, fq. 75). Ironia instinktive kapërcen çdo cak kur romani “Shembja e idhujve”, një titull ideal për të sotmen, po aq një model-dëshmie, jo gjurmësh të realizimit, por, saktësisht, i konformizmit korrekt me parimin bazë të partishmërisë komuniste në letërsi për të djeshmen, “kryqëzohet” në epokën e postdogmave dhe postideologjive... Megjithatë, edhe pas kësaj “kryqëzate” së jashtmi, sepse s’dua ta besoj “së brendshmi”, çka do të vinte në dilemë autorësinë e shkrimit, S. Drini sot është Laurat i Çmimit të Republikës” si reflektim serioz ndaj kodit të tij socio realist “duke manifestuar suksesshëm kodin e krijuesit postmodern në mjaft vepra të tij, veçanarisht në romanin “Korbi”, në të cilin lexohet fati ekzistencial i individit të lirë në realitetin absurd, ku, siç shprehej Hygoi, “... e pakuptueshmja është e bashkuar me të padepërtueshme, e padepërtueshmja është e bashkuar me të pashpjegueshmën, sikur e pashpjegueshmja është e bashkuar me pamatësinë”. (Xhaferri, një personazh dytësor i romanit, gardisti i burgut nazist, aktualisht e ka djalin deputet në parlamentin shqiptar, ndërsa “heronjtë” e tij, Alberti shqiptar si dhe Korbi australian kthehen si miq në Shqipëri). Absurditeti i ndërzyer nga paralogjizma,

brenda vetë autorit të konstruktit tautologjik, nën peshën e sentimentalizmit të sëmurë, arin deri aty sa romanin “Shembja e idhujve” ta konsiderojë njërin nga 4-5 romanet më të mirë të letërsisë shqiptare, të cilin vetë kritika letrare e viteve 70-të, e vlerësonte si një roman i zakonshëm, që shquhej për “mungesën e një ritmi më të gjallë gjatë rrëfimit, çka bënte që veprimi të mos ishte dinamik dhe i shkathët” (Historia e letërsisë shqiptare të realizmit socialist, fq. 390), ndërsa kritika letrare perëndimore, e pasviteve “90-të, do ta vlerësonte si një veper “me merita letrare të kufizuara, stilistikisht më i dobët se sa romani “Midis dy kohëve” (R. Elsie “Historia e letërsisë shqiptare”, fq. 410), ndryshe, as i afërt me veprat më të mira të asaj periudhe filluar me “Qytetin e fundit” të Markos, “Lëndina e lotëve” e Laços, “Dasma e Sykos” e V. Koeshit, “Laureat i çmimit të Republikës”, “Lumi i vdekur” i Xoxes, “Skënderbeu” i Godos, “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zyllo” e Agollit, pa numëruar dhjetëra vepra të Kadaresë, e te tjera, e te tjera shembuj. Në asnjë studim apo vështrim kritik mbi letërsinë shqipe të socit, për hir të së vërtetës, Drini nuk rezulton krijuesi që la kanonin e vet, liberal, ndryshe që tentoi thyerjen e skemës së asaj metode, siç vepruan, qoftë edhe pa vetëdije, bashkëkohësit e tij: F. Arapi, K. Trebeshina, D. Agolli, P. Marko, B. Londo, I. Kadare, e te ttere, pa mohuar as konformizmin e tyre, sidomos në poezi, çka u manifestua edhe te z. Drini, shkrimtari që nuk i shpëtoi këtij konformizmi, siç ngjau, thuajse, me mbarë komunitetin e krijuesve shqiptarë, kur në jetën tonë artistike fryma e ligjeve të Luigjit XIV u ndie aq drastike, sa vetë modeli ynë diktatorial.

Në këtë kontekst kam bindjen se jam plotësisht brenda etikës profesionale, larg mjerimit provincial, aspak si paralelizëm, kur kujtoj “Letër Gogolit”, përmes së cilës kritikua i madh rus, Bjelinski, anatonte publikisht, pa mëshirë veprën “Letrat” të mikut të tij, Gogolit, Pushkinit të dytë të Rosisë, që, sipas Bjelinskit, “nuk e kupton se përse zemërohen njerëzit me të. Duhet t’ia shpjegojmë këtë: po i përgjigjem unë vetë” çka Gogoli, pa u kthyer ende nga Ostenda, do ta mirëpriste me shumë mirënjohje ndaj gjeniut kritik me këto fjalë: “Tani më duket se më keni thënë vetëm një të vërtetë të madhe se unë nuk e njoh aspak Rusinë” (Bjelinski, “Artikuj kritikë”, fq. 470).

Përfundimi vjen krejt i qartë: Drini, jo thjeshtë, nuk arriti të krijojë modele fundamentale letrare gjatë socit, siç pretendon “I fundmi i disidentëve”, pa mohuar aspak si vlera serioze romanin biografik “Bajram Curri”, romanet “Vraje tradhtinë”, “Shqiponja e kreshtave” dhe “Kompania e katërt”, roman për fëmijë, por ai, gjithsesi brenda së djeshmes, Socit, ai mbeti shkrimtari që nuk njohu asnjëherë censurën me konsekuencat që pësuan krijuesit bashkëkohës të viteve 70-të, të cilët tentuan duke e pësuar, jo pak herë, devijimin nga socio realizmi si: Agolli, Trebeshina, Kadare, Marko, e te tjere, sikurse poetët e rinj V. Blloshmi, G. Leka dhe T. Xhagjika që dënoheshin me vdekje, dy të parët me varje, i treti me pushkatim, ndërsa B. Xhaferri pësonte fatin e një odisije mallkimi...

Në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar të vitit 2002, S. Drini, “Njeriu i vitit 2013” në Shkodrën e tij, gëzon një status nderi referuar edhe vlerave artistike, sado të kufizuara të romanit “Shembja e idhujve”, çka të bindë se shpallja e tij sot si “I fundmi i disidentëve” vjen sa si lojë fjalësh, nën ekstazën e një disidencje si idhujtari pa krena, e cila, po aq, na ofrohet si konstrukt tautologjik i një disidencje të stisur, në të cilën s’i besohet filozofisë estetike të krijuesit, por sofizmës, përndryshe argumentit të rremë, i cili gjithsesi nuk vjen i vullnetshëm, apo paralogjizëm, ku argumenti i gabuar, viktimisht, nën trysinë e sentimentalizmit të sëmurë, zhvillohet me besimin se po arsyetohet drejt.

# KUSH PO I MASHTRON DHE PAJTON ME XHELATËT E BEOGRADIT DISA PARTI POLITIKE SHQIPTARE NË KOSOVËN LINDORE PËR DALJEN NË ZGJEDHJET E 16 MARSIT-2014 TË SERBISË

KOMENT I VËSHTRIMIT DHE VLERESIMIT



Reshat AVDIU, Preshevë

Prania dhe vazhdshmëria e pushtetit represiv serb në Luginë të Preshevës, ka arrijtur në një moment tepër të tensionuar me tendencë të acarimit të matutjeshëm të situatës politike dhe të krizës së theksuar ekonomike në këtë rajon tejet të varfur shqiptar dhe më gjërë. Fuqitë e mëdha botërore sot gjithkund nëpër rajone ndezin vatra të tensionuara, pastaj kur flaka e këtyre luftërave merr përmasa të mëdha, po të njëjtat fuqi botërore të vendosjes tentojnë që zjarrin t'a shuajnë me një të sjellur nga një tantan i madh dhe gjithçka t'a shëndrojnë në fluskë sapuni. Kur ne shqiptarët e Luginës së Preshevës u vetëdijesuan për të drejtat tona legjitime, edhe neve këto fluska sapuni na u servuan dinakërisht, me marrvëshjen e Konçulit. Ku do t'a ndalnin për një moment të caktuar luftën e drejtë dhe të pakompromis të UÇPMB, kinëse për t'i dhënë shansë zgjidhjes paqësore në këtë pjesë të Shqipërisë së Vjetër Verilindore, e cila një shekull e më tepër është nën kolonializmin dhe hegjemonizmin serbo-sllav të Karpateve të Rusisë.

Qysh në fillim të bisedimeve në Konçul, thelbi i tezës ishte më se i qartë tentohej të krijohet përshtypja e rreme, se ne shqiptarët nga Lugina e Preshevës, mund të fitojnë diçka pas kësaj marrvëshje. Serbia, nga ai moment përsëri filloi t'a mbrehë, thikën në farkë që nga mëngjezi gjerë në darkë. Sepse kësaj të fundit i mbetën duart e lira për të vepruar dhe bashkërenduar për t'na eliminuar, kësaj rradhe përfundimisht neve shqiptarët si qenie biologjike, nga trojet tona etnike në Shqipërisë e Vjetër Verilindore si në: Preshevë, Bujanoc dhe Medvegje. Sepse ushtrisë sonë ua muarën armët ndërkombëtarët për t'ua shkelë dhe copëtuar me tanket e tyre.

Popull! i Luginës së Preshevës! Armiqët, dhe disa servilë tanë partiak, po tentojnë sot t'i godasin dy lepuj me të njëjtin guri: Krijohet një etnitë serb në Kosovë, ndërsa nga ana tjetër Lugina e Preshevës, mbetet e kolonizuar-gjë e garantuar përmes pranisë së ushtrisë dhe xhandarmerisë serbe këtu tek ne. Pastaj krijohet, krejtësisht përshtypja tjetër e rreme në popull e barazimit, të një pjesë të Kosovës, tokë shqiptare, me Luginën e Preshevës, kinse tjetër tokë shqiptare,

për t'i realizuar premiset e asaj që në fakt Beogradi e dëshiron sipas logjikës së tij aneksoniste-shoveniste. Ky është një pazar i fëlliqur për shkaputjen e një pjesë bukur të madhe të Kosovës në këmbim me Luginën e Preshevës. E kjo është e papranueshme, për popullin tonë të Kosovës Lindore dhe bijtë e saj liridashës të ish-UÇPMB-së, dhe veprimtarëve tjerë të çështjes sonë të madhe, e së bërit Shqipërinë Shqipëri. Dhe se këtë nuk do të lejomë dhe pajtohemi kurra-kurrës, që as edhe një pëllëmbë tokë shqiptare të këmbet as të mbetet nën pushtimin e kolonializmit serb dhe sllavo-maqedonas.

Zotrinjë kolaboracionist të Beogradit! Popullatën autoktone të kësaj ane të Shqipërisë së Vjetër Verilindore, e keni sjellë me thikë në fyt, tash së fundi kur po trubetohet me të madhe nga faktori i jashtëm dhe ai i mbrendshëm për daljen apo mos daljen e shqiptarëve autokton nga Kosova Lindore në zgjedhjet e 16 marsit të një shteti represiv të apartejdit e që popullatës shqiptare në tri komunat shqiptare u ka sjedhë vetëm se kob dhe hata të mëdha. Neve nuk na ka mbetur gjë tjetër, vetëm t'a përsërisim dhe t'a raelizojm në praktikë ate apotheozën e Rilindasëve tanë mbi robërimin dhe glabërimin e tokave të Mëmëdheut tonë e cila thoshte: "Jo për besë nuk duam azgjë nuk, vetëm se armë edhe ca bukë."

Partitë shqiptare në shtrirjen e tyre gjeografike duhet me të drejtë sot t'a ngrisin problematikën në instanca më të larta ndërkombëtare, çështjes e pronave tona të paqetërsueshme në Shqipërinë e Vjetër Verilindore të Nishit, Toplicës dhe Kazanë e Vrajës. Se ato troje stërgjyshore gjer më sot nga askush as nuk u blenë dhe as nuk u shitën por vetëm se u suprimuan me dhunë dhe terror, gjatë viteve 1877-1878, nga pushteti atëbotë i Millan Obrenoviqit, i cili e parapëlqente shtetin e tij një nacional serb, dhe do të propozonte atëbotë: "Sa më pak që të ketë shqiptar në mesin tonë, aq më e madhe do të jetë merita për atdhe dhe sa më shumë shqiptarë që të shpërngulni, aq më i madh do të jetë sukcesi për Serbi". E njëjta praktikë sot po na përsëritet edhe në Kosovën Lindore. Metoda këto ndër më prefidit të parapërgaditura nëpër kuzhinat e SAN-ës së Beogradit mbi dëbimin dhe eliminimin e shqiptarëve nga trojet e veta. Sepse projekti madhor i kanalit që ishte projektuar qysh më 1909, do të kalojë nëpër dy komunat më të mëdha shqiptare të Bujanocit dhe të Preshevës nuk do të shkojë nga Kumanova por përmes fushës Bllatë të Leranit do arrij te kisha mbi këtë katund dhe do të priten dy kodrinat e Shatkin Virit dhe do të zbresë poshtë në lumin Pçinja dhe nga aty te ura e Katllanovës ku Pçinja derdhet në Vardar dhe përmes Vardarit dhe lumit Aksios në Greqi kanali do të lidhet

me portin e Selanikut. Shtrohet pyetja pse? Sepse kjo vepër gjigante duhet të kalojë ekzkluzivisht vetëm se nëpër tokat serbo-sllavo-maqedonase, dëshira dhe nostalgjia e kahershme serbe do të bëhej realitet që Serbia të ketë dalje në dy derat e ngrohta të Egjeut dhe atij të Jonit. Dhe se shqiptarët e Kosovës Lindore duhet të dëbohen me metodat më prefide serbe për në Kosovë e gjetiu nëpër vendet perëndimore se këto dy komuna shqiptare ua prishin vazhdshmërinë territoriale sllavo-serbo-maqedonase.

Të njëjta praktika Serbia i kishin vazhduar edhe gjatë viteve 1912-1941, atëbotë një kryeçetnik shkruante: "Do të isha shumë i lumtur, kur Kosta Peçanci do të na japë urdhër neve serbo-çetnikëve të tij, dhe se lumejtë e Kosovës si: Llapi, Sitnica, Ibri dhe Drini do të bartin dy muaj koka të shqiptarëve, dhe se në Kosovë nuk do të mbetet, asnjë plisë për fare. Pastaj do t'i ndërtojmë kampet e pëqëndrimit, për shqiptarët se ata të gjithë janë kriminel... shkruhej më 1945, për shfarosjen dhe eliminimin qenies biologjike të shqiptarëve.

Ndërsa në planin e Millosheviqit dhe klikës së tij morbide gjatë viteve 1989-1999, për shfarosjen e popullatës shqiptare thuhej: a) Në Kosovë toka e djegur duhet, t'i përfshijë të gjitha anët e saj. b) Tymi i vatrave shqiptare të dëshmojë, se ato vise janë fikur përgjithmonë. c) Kufomat e karbonizuar të shqiptarëve dhe shtëpitë e bëra shkumb e hi të shkaktajnë trishtim vdekjeprurës. ç) Botës t'i themi: Po i vrasim shqiptarët, se po na detyrojnë. d) Toka e Shën Savës duhet të hakmeret, shqiptarët i pastron vetëm se thika. Pastaj një praktikë e njëjtë na u përsërit, edhe nga pasardhsit tjerë serbë të tij, të Boris Tadiqit e Ivica Daçiqit në Luginë të Preshevës, duke i arrestuar ish-ushtarët e UÇPMB-së, pastaj prania e ushtrisë dhe xhandarmerisë serbe dëshmon se qeveria e Beogradit pas protestave gjithpopullore në Kosovën Lindore, mbi mënjanimin e

lapidarit të dëshmorëve të UÇPMB-së nuk u ndërjegjësua aspak, që t'i rrespektojë shqiptarët, se ajo ende punon me metodat e vjetra mitomane çetnike.

Taktika e SAN-ës serbe është si zakonisht "pushto, mashtro, asimilo e sërish pushto" nga Beogradi tani krejtësisht është e qartë! Kërkojmë urgjentisht nga faktori i jashtëm dhe ai i mbrendshëm, që kësaj situatë kolonialiste serbe t'i jepet fund në Kosovën Lindore, e jo të na ftojnë që të dalim ne zdhjet e pa vlera serbe se neve shqiptarëve po na kërcnohet ardhmëria jonë etnike, ne mund t'a pësojmë keq, në të njëjtën mënyrë si vëllezërit tanë muhaxhirë, të cilët u zhvendosën barbarisht, nga ushtria piromane dhe vrastare serbe nga trojet e Shqipërisë së Vjetër Verilindore si nga: Toplica, Nishi, Piroti, Negotini, Zajçari, Prokupja, Kurshumlia, Leskoci, Vraja ... e te tjere.

Ne, shqiptarët e Luginës së Preshevës, për fatin tonë të hidhur nën kolonializmin dhe hegjemonizmin serb, kemi vendosur vet me referendum gjithë popullor më 1 dhe 2 marsit të vitit 1992, dhe për ta vullosur më pastaj këtë plebiashit gjithë popullor me gjakun e derdhur të bijve tanë dëshmor të UÇPMB-së në të tria komunat tona shqiptare të Shqipërisë së Vjetër Verilindore si në: Preshevë, Bujanoc dhe Medvegje. E jo sot disa të vetshpallurit përfaqësues partiak të soit dhe të sorollapit-millosheviqian e çubrilloviqian që manipulojnë me fatin tragjik dhe dramatik të kësaj popullate të përvuajtur shqiptare në tria komunat tona shqiptare.

Në fund sa herë që të tjerit kanë vendosur për fatin tonë, ne shqiptarët gjithmonë kemi pësuar shumë keq dhe është dashur që të derdhen pastaj lumenj gjaku për të drejtat tona legjitime, edhe ate gjatë tërë historisë sonë të lavdishme, këtë jo që po e them unë si një ish i burgosur i ndëgjegjës shqiptarë, por për këtë flet një det i tërë argumentesh dhe faktesh të pakontestueshme historiko diplomatike.

## Gëzuar 7 e 8 Marsin!

Me rastin e 7 e 8 Marsit, dy festave të dashura për të gjitha shtresat e popullit tonë, Dega e Shoqates "Atdhetare-Dukagjini" për Tiranën, uron mësimdhënësit dukagjinat të çdo niveli të sistemit tonë arsimorë, që kontribuojnë në këtë sektor të rëndësishëm të edukimit si edhe pensionistet e nderuar të këtij sektori. Gëzuar 7 Marsin!

Gjithashtu urojmë nënat, motrat e gratë dukagjinase kudo ku jetojnë e punojnë, sepse Ju keni mbartur, mbani e trashëgoni vlerat më të mira të femrës shqiptare. Gëzuar 8 Marsin!

## REDAKSIA

Kryeredaktor: Lazër Kodra

Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Luigj Shyti, Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja